

ÇFARË ËSHTË DAVETI?



Thirrja Islame është e gjitha mirësi dhe drejtësi, sepse ajo vërtitet rreth gjërave që i pranon logjika e shëndoshë, që tërheqin njeriun me prirje të pashtrembëruar dhe që i japin qetësi zemrës së pastër. Ajo është thirrje për të besuar tek Allahu, në veprat e Tij të veçanta, në emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta; për t'ia kushtuar ibadetet vetëm Allahut dhe për të mohuar adhurimin e gjithçkaje tjetër veç Tij; është thirrje për të besuar në të Dërguarin e Allahut Muhamedin, për të ndjekur rrugën e Tij, për të zbatuar urdhrat e tij, dhe për ta marrë atë si shembull në adhurimin e Allahut; është thirrje për të përqafuar Islamin si feja e vetme e pranuar tek Allahu dhe për zbatimin e ligjeve të Sheriatit. Ndër elementët kryesorë të thirrjes islame është edhe vendosja e drejtësisë mes njerëzve, formimi i familjes së rregullt, ruajtja e nderit, respektimi i prindërve, edukimi i fëmijëve me edukatë të shëndetshme, përmirësimi i sjelljes së njeriut, luftimi i padrejtësisë, sjelljes së keqe, veseve të ulëta dhe punëve të turpshme, moscenimi pa të drejtë i jetës, pasurisë dhe dinjitetit të njeriut, promovimi dhe mbrojtja e vlerave njerëzore. Thirrja e vërtetë islame që buron nga Kurani Famëllartë dhe Suneti i saktë, si dhe metoda e muslimanëve të brezit të parë, synon t'i nxjerrë njerëzit nga adhurimi i njerëzve apo çfarëdolloj krijese tjetër për në adhurimin e Zotit të njerëzve, nga padrejtësia e feve, ideve dhe sistemeve të ndryshme, për në drejtësinë e Islamit, nga ngushtësia e dynjasë për në hapësirën e amshuar të ahiretit. Përqafimi dhe jetësimi i kësaj thirrje e bën jetën e njeriut të lumtur, të kënaqshme dhe të begatë, si në këtë botë edhe në botën tjetër, pasi Allahu thotë: ***“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë”***. Nahl: 97.

Thirrja për në rrugën e Allahut është puna që kryen të gjithë të Dërguarit e Allahut, dhe si e tillë ajo është një ndër punët më të mira që bën muslimani. Thirrësit për në fenë e vërtetë të Zotit janë trashëgimtarët e Pejgamberëve. Ata i orientojnë njerëzit drejt Zotit të tyre dhe u ndriçojnë atyre rrugën e xhenetit. Ata janë pishtarët që të bëjnë dritë për të marrë rrugën e Zotit në mes të errësirës së feve, ideve dhe sistemeve të humbura. Duke qenë se thirrja ka të bëjë me bindjet, mentalitetet, idetë, normat e sjelljes, zakonet dhe traditat e njerëzve, ajo është puna dhe detyra më e vështirë që mund të marrë përsipër njeriu, për vetë natyrën e gjërave të tilla, të cilat nuk ndryshojnë aq lehtë. Mbase sot është më e lehtë të ndërhysh në fizikun e njeriut, sesa në mentalitetin, bindjen dhe sjelljen e tij. Puna e thirrësit duket akoma më e vështirë po të marrim parasysh edhe faktin që përballë ka një armik me një përvojë të gjatë dhe me një ushtri të madhe, sikurse është shejtani i mallkuar. Pikërisht për këto arsye dhe shumë të tjera Allahu zgjodhi njerëzit më të mirë për bartjen e mesazhit hyjnor dhe përcjelljen e tyre tek njerëzit. Allahu kishte mundësi t'u jepte të dërguarve fitoren mbi kundërshtarët e tyre pa u dashur të përballen me sfida, vështirësi, mundime dhe stërmundime, dhe pa kërkuar ndonjë sakrificë apo përpjekje prej tyre, por ai e ka bërë ligj që t'i sprovtojë njerëzit me njëri-tjetrin dhe më në fund të nxjerrë si triumfues të dërguarit dhe pasuesit e tyre. Zoti i Lartësuar thotë: ***“Sikur të donte Allahu, do t'i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t'ju sprovtojë juve me njëri-tjetrin”***. Përveç sfidave që përmenda më sipër, thirrësve të trojeve tona iu duhet të përballen edhe me shumë sfida bashkëkohore të rrafshit global, por nuk janë të pakta edhe sfidat lokale, të cilat kanë natyra dhe burime të ndryshme. Ndonjëherë thirrësi, ndërsa përpiqet të vejë ndonjë tullë për ngritjen e ngrehinës që sapo ka filluar të thirrjes dhe xhematit të muslimanëve, mund të ndeshet edhe me njerëz që bëhen pengesë për ngritjen e kësaj ndërtese, ose akoma më keq që punojnë për shembjen e saj, dhe një sfidë e tillë nuk vjen vetëm nga qafirët, por nganjëherë edhe nga muslimanët e paditur, ose gjysmë të ditur, me qëllim e pa qëllim. Atëherë për tu bërë ballë të gjitha këtyre sfidave dhe për të çarë rrugën përpara deri në afatin e caktuar nga Allahu, thirrësit i duhet dituri e gjerë, sinqeritet, devotshmëri, durim, pjekuri, maturi, shpirtmirësi, trimëri, bujari dhe angazhim e punë me vetëmohim e pa lodhje.

Në emër të redaksisë: Ismail BARDHOSHI

AKTUALE

3-4 | EVROPA... KTHIM MBRAPA!

5-6 | TALEBANËT DEMOKRATË!?!...

7-8 | BLIC LAJME

SFIDA

9-11 | MOBILIZIMI SHPIRTËROR

AKIDE

12-15 | TEUHIDI PARA SË GJITHASH

DRITARE

16-20 | BIOENERGJIA

20-25 | NJË PISHTAR MË PAK

MUHAMED XHEMIL ZEJNO (1925-2010)

FIKH

26-29 | TRASHËGIMIA E FEMRËS NË ISLAM 2/2

EKONOMI

30-32 | KLAUZOLA NDËSHKUESE OSE GJOBA E VONESËS

FAMILJA

33-37 | NË KUJTESËN E FËMIJËS TËND...

SHKRUAJ HISTORI ME TË CILËN DO TË MBURRET

38-41 | GRUAJA E MENÇUR E PËRFITON BURRIN EDHE
NËSE AI E URREN

42-45 | GRUAJA MUSLIMANE DHE PËRGJEGJËSITË E
DAVES (2/2)

TEFSIR

46-48 | RRUGA E DREJTË ËSHTË AJO E MUHAMEDIT
SAL-LALLAHU ALEJHI UE SELEM

HADITH

49-53 | PASHA ALLAHUN, KJO FE DO TË PËRHAPET

THESARE

54 | ASPEKTI SHKENCOR I NJË HADITHI MADHËSHTOR

AVANCIMI PERSONAL

55-57 | ELIMINIMI I DRUAJTJES

FETVA DHE KONSULTIME

58-60 | SI TË THËRRAS NË RRUGËN E DREJTË

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,

Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA dhe Rashit ZYLFIU

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)

xhirollogaria: 0270100245547

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)

Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T.: KOBSMK2X

IBAN: MK07300701002455425

numri tatimor: 4030008038784



EVROPA... KTHIM MBRAPA!

Evropianët tashmë kanë mbetur me nacionalizmin e tyre, i cili u humbi gjatë vrullit kur ata përqendroheshin në parime që nuk bartnin brengën e nacionalizmit, siç ishin liria e mendimit, liria e besimit, liria e punës, barazia, dashuria ndaj tjetrit dhe harmonia me tjetrin në një shoqëri të njëjtë

ISLAMTODAY/LONDËR

Pa dyshim që rënia e parlamentarizmit me kaq lehtësi në duart e partive të djathta ekstreme konsiderohet shou më i madh politik në kontinentin evropian, që nga përfundimi i epokës së komunizmit. Ky ndryshim numërohet si rilindje për djathtëzimin dhe partitë ekstreme në një kontinent që filloi ta ndërrojë kahjen dhe të hulumtojë një ardhmëri të re pasi kaloi njëqind vite qëndrueshmëri. Vërehet se zgjedhjet e fundit në Suedi, ku partia demokratike djathtëiste ekstreme fitoi njëzet deputetë në parlament, nxjerrin në pah atë, se për herë të parë Evropa ka filluar praktikisht ta ndërrojë lëkurën e saj dhe po e sheh të ardhmen në një kah të ri. Tashmë jeta

e përbashkët me të gjitha etnitë, fetë dhe tregjet e hapura nuk po i kënaq më aspiratat e evropianëve.

Evropianët tashmë kanë mbetur me nacionalizmin e tyre, i cili u humbi gjatë vrullit kur ata përqendroheshin në parime që nuk bartnin brengën e nacionalizmit, siç ishin liria e mendimit, liria e besimit, liria e punës, barazia, dashuria ndaj tjetrit dhe harmonia me tjetrin në një shoqëri të njëjtë. Ky duhet të jetë shkaku pse votuesit po i japin votën e tyre partive që po ngjallin aspektin nationalist në venat e tyre. Para një dekade të plotë evropianët "i gjuanin" anëtarët e partive të djathta dhe përkrahësit e tyre, kurse sot shohim partitë e tjera se si ka filluar të vërehet në agjendat e tyre politike, madje edhe në fjalimet elektorale një frikë e ndikimit të të djathtëve, që është në rritje e

sipër në kontinentin demokratik, që përfshin 46 shtete.

E çuditshme është se këto parti djathtiste kanë filluar të lulëzojnë, të rriten dhe të tërheqin elektoratin e gjerë, megjithëse nuk ka ndonjë rrezik të caktuar që momentalisht e kërcënon Evropën, edhe pse trumbetohet për luftën, terrorizmin dhe kësi klisesh të vjetra. Sidomos pasi Shtetet e Bashkuara ndryshuan dhe nuk janë më sponsorizues dhe frymëzues për t'u përballur me këtë rrezik siç ishte situata në kohën e kryetarit të kaluar amerikan Xhorxh Bush. Kështu edhe pa ekzistimin e një armiku të caktuar, në Evropë vlerat nacionaliste u bënë thelbësore, ndryshe nga vlerat shoqërore që kultivonin partitë e majta dhe socialistët. Ky grup i ri nacionalistësh që besojnë në parime ekstreme tashmë janë bërë një forcë që nuk duhet nënçmuar, janë rrugës për të skicuar një epokë të re politike evropiane. Analistët politikë thonë me vendosmëri se shkak i zmbarsjes i të majtëve, parimeve të tyre dhe besimit të votuesve ndaj tyre në Evropë i takon asaj se këto parti gëzojnë një vetëbesim ekstrem, që me kohë është shndërruar në vetëmashtrim dhe gdhinë të atillë që nuk e dëgjojnë zërin e askujt përveç të vetin. Këto parti nuk bënë asgjë për bashkëkombësin evropian, edhe pse vërenin se po veçohen dhe po largohen nga populli pak e nga pak. Prandaj metoda e qytetarit për ta ndëshkuar partinë që nuk angazhohet për të, për interesat e tij është gjetja e një zëvendësimi tjetër edhe në qoftë se ai zëvendësim është i hidhur. Partitë e majta e kanë humbur popullaritetin për shkak të mospërfilljes së qytetarit, presioni i tyre i përditshëm shtohet duke i rritur edhe më shumë tatimet.

Këtu ka edhe një shkak pse evropianët u japin epërsinë këtyre partive dhe hyjnë në krahun e ekstremizmit djathtist. Ai shkak personifikohet në krizën financiare dhe pasojat e saj e po ashtu edhe prania e

“...Ka edhe një shkak pse evropianët u japin epërsinë këtyre partive dhe hyjnë në krahun e ekstremizmit djathtist. Ai shkak personifikohet në krizën financiare dhe pasojat e saj ...”

komuniteteve të huaja, që po rrëmbejnë punësimet e qytetarëve të vendit. Kështu u shfaqën të djathtët si qetësues efektiv dhe i menjëhershëm për të frenuar etnitë e tjera dhe për të zvogëluar përgatitjen e tyre dhe kështu arritën kënaqësinë dhe pëlqimin e qytetarit evropian. Shumë prej mbikëqyrësve të situatës mendojnë se fronti më i madh i demokracisë në botë (Evropa) aktualisht po ua shtron rrugën këtyre partive të djathta ekstreme. Fronti Kombëtar Francez ka fituar 11.9% të votave, partia e djathtë Lidhja e Veriut (Lega Nord) në Itali ka fituar 8.3% nga numri i përgjithshëm i votave, ndërkohë partia Holandeze e Lirë në Holandë ka marrë 15.5% të votave, Partia Popullore zvicerane ka marrë 28.9% të votave si dhe partia Jobek në Hungari ka marrë 16.7 të votave.

Gjithashtu parti të djathta ekstreme kanë fituar një numër të madh votash në disa shtete të tjera evropiane, si në Belgjikë, Letoni, Sllovaki dhe Slloveni. Ndërsa anketat bëjnë me dije se numri i votave që po fitojnë partitë e djathta në shtete të ndryshme të Evropës është shtuar me një përqindje nga 5% deri në 15%. Në përfundim, ky përparim i ri në ndërtimin e politikës evropiane ndoshta ka të bëjë thjesht me një ndryshim, me dëshirën e qytetarëve që të gjejnë një zëvendësim më të mirë dhe më të fortë për t'i realizuar ëndrrat e tyre, të cilat nuk arritën t'i realizojnë partitë e tyre të vjetra. ■

Përktheu: Omer B.

TALEBANËT DEMOKRATË!?!...

Shumë shpejt talebanët do të bëhen pjesë e pushtetit në Afganistan, do të fitojnë mbështetje nga donatorët dhe bekimi i Uashingtonit, madje – në sytë e Uashingtonit – do të shndërrohen nga një lëvizje e errët në një lëvizje përparimtare demokratike

MUSTAFA ZEJN

Pas nëntë viteve ngatërrim këmbësh në Afganistan, Shtetet e Bashkuara e kuptuan atë që e provuan okupatorët e mëparshëm të atij vendi, duke filluar nga britanikët në shekullin XIX për të përfunduar me sovjetikët në shekullin XX. Pa dëshiruar të kthehemi në ditët e

Aleksandrit të Madh: Të triumfosh në këtë vend është e pamundshme, ndaj erdhi edhe vendimi i kryetarit Barak Obama, që të fillojë tërheqjen e forcave në Korrikun e ardhshëm. Por si hyrje ishte shtimi i forcave dhe fillimi i kontakteve me lëvizjen talebane apo me ndonjë krah të saj për të garantuar tërheqjen e Musharafit dhe mbrojtjen e Hamid Karzait apo të ndonjë tjetri, që janë



besnikë ndaj Uashingtonit në udhëheqjen e vendit.

Administrata amerikane përzgjedhi Xhelaludin Hakanin për të filluar bisedimet me talebanët. Ky njeri është i njohur si një ndër komandantët me forcë dhe ekstremizëm më të madh në atë lëvizje. Uashingtoni e njeh mirë, pasi ai ishte një aleat i fortë gjatë okupimit sovjetik dhe në atë periudhë e konsideronte si heroin e lirisë. Atij i përkasin meritat që talebanët arritën pushtetin në vitin 1996, me përkrahjen e Inteligjencës pakistaneze (ISI), e cila i ofroi atij marrjen e pushtetit në Kabul pas “betejave” në Nju Jork dhe Uashington më 11 Shtator, mirëpo ai e refuzoi këtë për shumë shkaqe, ndër to besnikëria ndaj talebanëve dhe liderit të tyre Mulla Omarit, miqësia me Bin Ladenin, si dhe nuk kishte dëshirë të përballet me fiset afgane, në veçanti me fisin Bushtun, shumica e të cilëve janë me talebanët. Kushti kryesor i amerikanëve për t’u pajtuar me talebanët do të jetë që ata ta braktisin “Al Kaedën” d.m.th. ndarja e luftëtarëve të huaj prej atyre vendas, me qëllim që të lehtësohet mposhtja e tyre. Njëlloj si kushtin që ia pat diktuar rezistencës irakiane, përpara se të formohej forca “Sahue”, që luftoi Al Kaedën dhe e dëboi nga zonat e saja.

Negociatat amerikane me Hakanin nuk do të jenë aq të lehta, sa i paramendojnë amerikanët, mirëpo nuk kanë rrugëdalje tjetër për të kufizuar humbjet ushtarake dhe financiare, si dhe të përgatisin atmosferën për t’i dhënë rol Pakistanit, që deri tani akuzohej se përkrahte talebanët, në qoftë se duan që bisedimet të kenë sukses. Ky është edhe komenti për tensionimin e marrëdhënieve mes Islamabadit dhe Uashingtonit në periudhën e tanishme. Amerikanët e kuptuan pas pesë viteve çmenduri, se nuk do kenë mundësi ta

“...Amerikanët e kuptuan pas pesë viteve çmenduri, se nuk do kenë mundësi ta imponojnë vullnetin e tyre ndaj botës me forcën e armës, prandaj filluan të tërhiqen nga “Lindja e Mesme e Madhe”...”

imponojnë vullnetin e tyre ndaj botës me forcën e armës, prandaj filluan të tërhiqen nga “Lindja e Mesme e Madhe”. Mirëpo, problemi është se ata pas vetes lanë qeveri dhe sisteme – që më së paku mund të përshkruhen – të prapambetura dhe të korruptuara, të cilat për të mbetur në pushtet do të mbështeten tek amerikanët apo tek përkrahësit e tyre brenda, përkrahës që ende nuk e kanë kuptuar se koha e Bushit mbaroi. Kështu ndodhi edhe në Irak. Amerikanët do ta braktisin duke lënë pas vetes një sistem me aq shumë korrupsion, për të cilin do të hyjnë në konflikt grupacione, parti dhe etni. Të gjithë do të garojnë për të rritur hisen e pushtetit dhe të pasurisë. Këtë trashëgimi do ta lënë në Afganistan, ku fiset presin shansin që të hidhen në pushtet. Të njëjtën gjë mundohen ta bëjnë në çdo shtet ku gjejnë përkrahës, pa e okupuar atë fare. Shumë shpejt talebanët do të bëhen pjesë e pushtetit në Afganistan, do të fitojnë mbështetje nga donatorët dhe bekimi i Uashingtonit, madje – në sytë e Uashingtonit – do të shndërrohen nga një lëvizje e errët në një lëvizje përparimtare demokratike, që ndoshta do të ndihë kundër “shejtanit” iranian. A të drejtat e njeriut... vafshin në dreq! ■

Përktheu: Omer B.

BRACKEN: “KULLAT JANË SHPËRTHYER”

Kevin Bracken, sekretar i sindikatës detare të Australisë dhe president i Këshillit Viktorian të Tregtisë deklaroi në lidhje me ngjarjet e 11 shtatorit, se versioni zyrtar nuk përputhej me kërkimet shkencore në lidhje me faktin. Kjo deklaratë vjen në kuadrin e një debati që po vazhdon në Parlamentin Australian në lidhje me luftën në Afganistan. Bracken në një radio australiane deklaroi se Australia duhet që të nisë një hetim në lidhje me ngjarjet e 11 shtatorit, duke deklaruar se në sulmin në fjalë ishin përfshirë shumë elementë nga ish-administrata e Presidentit Bush, ushtria amerikane dhe shërbimet sekrete. “Në lidhje me këtë ngjarje ka shumë pyetje që kanë mbetur pa përgjigje. Fakti është që karburanti i avionëve nuk arrin kurrë një temperaturë të tillë të lartë sa të shkrijë çelikun dhe as para dhe as pas 11 shtatorit asnjë skelet çeliku nuk është shembur kurrë për shkak të zjarrit. Unë jam një person që preferoj t’u përmbahem fakteve shkencore dhe sipas mendimit tim kullat janë shpërthyer”, ka deklaruar zyrtari. Mendime të tilla Bracken i ka shprehur edhe në të shkuarën. Në vitin 2006, ai deklaroi për një gazetë australiane se sulmet patën sukses për të vetmen arsye, sepse qeveria amerikane ishte përfshirë vetë në njëfarë mënyre në to. Këto deklarata janë bërë gjatë një programi radiofonik dhe gazeta mbeti shumë e befasuar nga komentet.

FALTORE PËR MUSLIMANËT NË KLINIKËN UNIVERSITARE NË SHKUP

Me faljen e dy rekateve namaz ministri i Shëndetësisë në RM, Bujar Osmani, zyrtarisht lëshoi në përdorim faltoren myslimane në Qendrën Klinike të Shkupit. Ministri Osmani theksoi se ky objekt fetar

do t’i mundësojë personelit mjekësor, pacientëve dhe familjarëve të tyre të kryejnë obligimet e tyre fetare. Sipas tij ky objekt u lëshua në përdorim pas kërkesave të shumta të pacientëve të përkatësisë fetare islame. Faltorja e re ndodhet në afërsi të Klinikës së fëmijëve dhe është i pari i këtij lloji në rajon. “Është kjo një kërkesë e kamotshme e pacientëve, është kërkesë e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, është një e drejtë themelore bazike e pacientëve për të pasur mundësinë për të kryer obligimet e tyre fetare, është një praktikë e shëndetësive moderne në Evropë, është praktikë në sektorin privat në Maqedoni. Më vjen mirë që tani edhe në shëndetësinë publike po krijojmë këto parakushte për të realizuar të drejtat themelore të pacientëve”,- tha ministri i Shëndetësisë Bujar Osmani. Mjekët, pacientët dhe qytetarët shprehen se ky objekt fetar, do të ndikojë në shërimin shpirtëror të njerëzve, por do të jetë edhe nxitje për autoritetet për përmirësimin e kushteve të tjera nëpër spitale. “Sigurisht që është një nevojë e kohës, nga arsyeja se është rritur numri i punonjësve në klinikën këtu në Shkup, të cilët i përkasin fesë islame dhe lutja apo namazi është një obligim për çdo besimtar. Ashtu që kjo vërtet ishte nevojë e kohës” tha mjeku Rexhep Memedi. “/alsat-m/

MASAKRA E DUBRAVËS U KRYE NGA SERBËT

SERBI- Masakra e të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, është kryer me urdhër të Qeverisë së Serbisë. Kështu pohon Prokuroria Serbe për Krime Luftë, e cila ka siguruar dokumentin që e ngarkon ministrin e atëhershëm serb të drejtësisë, Dragolub Janković, dhe zëvendëskryeministrin Nikolla Shainović, për krimet e luftës në burgun e Dubravës afër Istogut. Me urdhër të tyre të burgosurit serbë për krime të rënda u transferuan në

burgun e Dubravës, për të larë hesapet me të burgosurit shqiptarë. Siç shkruan e përditshmja “Danas” gjatë hetimeve është zbuluar se mbi të burgosurit shqiptarë fillimisht u hap zjarr me pistoleta dhe pushkë. Pastaj kur të dyshuarit e kuptuan se për këtë krim nuk mund ta “akuzonin NATO-n, qëlluan nëpër dhoma me predha. Pas krimit, rreth 90 për qind e të burgosurve serbë morën pushim nga 15 deri më 20 ditë, dhe nuk u kthyen me kurrë për të vazhduar dënimin. Fondi për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd në maj të këtij viti ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë për krime lufte kundër 34 përgjegjësve për vrasjen e mbi 90 të burgosurve shqiptarë dhe plagosjen e më se 150 të tjerëve në burgun e Dubravës. /BalkanWeb/

HOLANDË: KOKA TË PRERA DERRASH NËPËR XHAMI

Në Holandë me ardhjen në krye të detyrës të qeverisë se re të pakicave, e cila u formua me mbështetjen e partisë raciste Lira, sulmet kundër turqve dhe marokenëve janë shtuar. Përshkallëzimi i sulmeve kundërt xhamive ka filluar të shkaktojë shqetësim. Partitë opozitare sulmet në fjalë i ngritën në rendin e parlamentit. Javët e fundit sulmet kundër xhamive në Holandë janë dendësuar në mënyrë të ndjeshme. Ndërkohë që në qytetin Dordrecht një xhami është sulmuar me armë, një xhamie tjetër në Gronigen i është vënë zjarri. Muret e shumë xhamive janë shkarravitur me slogane raciste, si dhe janë lyer me gjak derri. Nëpër disa xhami janë hedhur edhe koka të prera derrash. Partia e Majtë e të Gjellbërve dhe Partia Laburiste kanë paraqitur në parlament nga një interpelancë. Partia Laburiste gjithashtu ka kërkuar që parlamenti të mblidhet në një seancë urgjente për të diskutuar sulmet kundër muslimanëve dhe faltoreve të tyre. Ky propozim është përkrahur edhe nga Partia e Majtë e të Gjellbërve. /TRT/

NË RRETHINAT E TEHERANIT PENGOHET EHLI SUNETI TË FALË NAMAZIN E XHUMASË

Autoritetet iraniane penguan muslimanët (sunitët) të falin namazin e xhumasë në pjesën e parë të muajit Tetor në disa pjesë të rrethinave të Teheranit, ndërkohë që edhe në Teheran Ehli Suneti nuk kanë asnjë xhami ashtu që namazin e xhumasë dhe të tjerat i falin nëpër ca shtëpi apo lokale që i kanë marrë me qira për atë qëllim. Një nga të angazhuarit në Grupin për Davet dhe Përmirësim në Iran thotë: Fatkeqësisht, janë shumë kontradiktore sjelljet e autoriteteve lidhur me këtë çështje, në një anë ministri i punëve të brendshme e mohon një ndalesë të atillë – kur pati një takim me deputetë sunitë – që do të ndalonte ritualet fetare të Ehli Sunetit, ndërsa në anën tjetër gjejmë prefektin e qytetit “Kuds” personalisht të ndalojë faljen e namazit të xhumasë në datën 16 Tetor. /almoslim.net/

THOMAS: KUSH FLET KUNDËR IZRAELIT NË SHBA MERR FUND

“Unë them atë që mendoj. Kush flet kundër Izraelit në këtë shtet (SHBA) nuk qëndron dot në këmbë”, theksoi Helen Thomas. 90-vjeçarja Thomas, raportuesja më e lartë e Shtëpisë së Bardhë, duke kritikuar politikën e Tel Avivit kundërt Gazës, theksoi gjatë muajit qershor se është e nevojshme që izraelitët të ikin nga Palestina dhe se “hebrejtë e Palestinës duhet të kthehen në Gjermani, Poloni dhe në Amerikë”. Këto komente u bënë shkak që ajo të largohej nga puna që bënte prej 50-vitesh./start/

MOBILIZIMI SHPIRTËROR

tjetër jomuslimanët dhe ateistët në shumicën e rasteve e ndiejnë veten të pangarkuar me detyrime dhe të lirë në zgjedhjet e tyre. Një realitet i këtillë në shumicën e rasteve krijon ndjenjën e kufizimit tek shumë prej muslimanëve, që pastaj rezultojnë me shkelje të urdhrave dhe moskryerjen e detyrimeve

DR. ABDULKERIM BEKAR

Kundërthëniet ne sjelljen e shumicës së muslimanëve janë një realitet i pamohueshëm. Në të njëjtën kohë ne jemi dëshmitarë edhe të entuziazmit tek muslimanët për të arritur tek vlerat në të cilat besojnë. Edhe pse jam i bindur se çiltërsia dhe besimi i sigurtë në ndonjë parim janë motivuesit më frytdhënës për angazhimin në veprimtari me vullnet dhe seriozitet. Unë dëshiroj që së bashku me vëmendje t'i analizojmë edhe këto opsione:

-Muslimani nuk e ka optionin e zgjedhjes kur janë në pyetje shumë prej vlerave dhe veseve. Ai është i detyruar që t'i kryejë me zell



detyrimet si namazi, zekati, haxhillëku dhe në të njëjtën kohë të largohet me vendosmëri prej mëkateve si: zinaja, përdorimi i prodhimeve dehëse, bixhozi etj.

Nga ana tjetër jomuslimanët dhe ateistët në shumicën e rasteve e ndiejnë veten të pangarkuar me detyrime dhe të lirë në zgjedhjet e tyre. Një realitet i këtillë në shumicën e rasteve krijon ndjenjën e kufizimit tek shumë prej muslimanëve, që pastaj rezulton me shkelje të urdhrave dhe moskryerjen e detyrimeve, me kundërthënie mes asaj që thuhet dhe asaj që veprohet.

-Shumica e muslimanëve nuk e kanë pasur fatin të edukohen në kushte Islame dhe me përkujdesje të mirë lidhur me vlerat Islame. Për shumicën e tyre vlerat Islame janë diçka e panjohur, ose me një numër të konsiderueshëm të këtyre vlerave janë njoftuar në formë të gabuar, që në disa raste ka rezultuar me shëmtimin e tyre. Mënyra se si i kupton populli këto vlera, parime dhe dispozita Islame i ka ngjyrosur të njëjtat me ngjyrën e shoqërisë. Kjo ngjyrosje është forma se si e ka kuptuar dhe konceptuar **sheriatin** shoqëria në fjalë. **Ibën Xheuziu**, Allahu e mëshiroftë, e ka përshkruar bukur këtë realitet me këto fjalë: **Në kohën tonë kemi njerëz të cilët po të mundohesh që t'i detyrosh me dhunë të mos agjërojnë nuk do kesh sukses, dhe ka të tillë të cilët po të mundohesh me dhunë t'i detyrosh të falen ata nuk do të falen.**

-Përgjatë historisë largësia ndarëse mes asaj që besojnë dhe thonë mësuesit dhe edukatorët muslimanë, dhe asaj të cilën veprojnë ka qenë evidente! Një gjendje e tillë ka shkaktuar huti dhe konfuzion tek shumë nxënës, në lidhje me kuptimin e vlerave Islame. Rezultati ishte mosinteresimi i shumë prej tyre për këto

“...Më pikëllon mendimi i disa mendimtarëve që bisedën për çështjet shpirtërore i quan biseda dervishësh dhe naivitete...”

vlera.

Besoj se shkaqet që i numërova së bashku me disa shkaqe të tjera ishin shkaku pse realiteti i muslimanëve lidhur me parimet dhe vlerat Islame është ashtu si është.

Çfarë duhet bërë?

Besoj se rrugëdalja është një e vetme. Angazhimi ose thënë ndryshe rimbushjen shpirtërore gjithëpërfshirëse. Rryma dekadente e pasuesve të pasioneve, që si vërshim përhapen në botë, problemet dhe vështirësitë e jetës, sfidat e realiteteve bashkëkohore... nuk munden të ballafaqohen me hedhjen e teorive të reja. Kundërpërgjigja duhet të jetë një lëvizje e fuqishme shpirtërore, e cila do të siguronte karburant shpirtëror të mjaftueshëm në pritje të gëzimeve që afrohen. Ky karburant duhet të jetë i mjaftueshëm për përplasjen e fuqishme me të këqijat dhe pasionet e jashtëligjshme.

Analisti që lexon planet zhvillimore të shumë prej reformatorëve dhe iluministëve do të hasi në teoretizime mjaft të bukura. Shkrimet të tilla i ngjajnë një harte, e cila na drejton se si duhet të kalohet një rrugëtim bukur i gjatë dhe i vështirë, por në të nuk kemi informata për mjetin të cilin duhet ta përdorim për ta kaluar udhëtimin në fjalë!

Më pikëllon mendimi i disa mendimtarëve që bisedën për çështjet

shpirtërore i quan biseda dervishësh dhe naivitete. Realiteti vërtetohet se shumica e njerëzve që janë aktivë në fushat e veprimtarisë humane dhe vullnetare janë ata që e kanë stolitur veten me shpirtin e dëshirës për t'u afruar pranë Allahut, *subhanehu ue teala*, dhe për të fituar shpërblimin e Tij.

Nëse e analizojmë me vëmendje erën e bekuar të kohës, kur mbi tokë ecte njeriu më i dalluar që e kishte krijuar dhe dërguar Allahu, *subhanehu ue teala*, do të shohim se kujdesi për gjendjen shpirtërore (lexo: gjendjen e imanit) ka qenë në radhën e parë të prioritetëve. Një realitet i tillë shfaqej shumë herë, kur në beteja të ndryshme adoleshentët garonin me të moshuarit për ta fituar shpërblimin e shehidit. Të rinjtë para atyre që ishin pleq ishin gati të vdesin duke lakmuar pas të mirave që Allahu i ka përgatitur për dëshmorët. Shumë prej tyre punonin rëndë për ta fituar kafshatën e bukës, por në të njëjtën kohë ishin të gatshëm, që të mbesin vetë të uritur, duke e ndarë pasurinë që zotëronin si lëmoshë për nevojtarët. Mundoheshin që të ecin në rrugën e **Njeriut**, i cili natën e kalonte në adhurim dhe që i ënjteshin këmbët. **Njeriun** të cilin nuk e mashtronin bukuritë e kësaj dynjaje. **Njeriun** i cili për ditë të tëra nuk kishte se me çfarë të ushqehet.

Iu bëj thirrje që angazhimi për ta përmirësuar gjendjen shpirtërore të vendoset në agjendat tona personale në plan të parë. Zhvillimi shpirtëror duhet të jetë pjesë e pandarë e planifikimeve për zhvillimin shoqëror. Në të njëjtën kohë askush individualisht dhe si bashkësi nuk duhet ta kursejë veten për avancimin e këtij qëllimi fisnik-përmirësimi i gjendjes shpirtërore/imanore.

Kemi nevojë për ligjërata dhe kurse, që do ta thellojnë kuptimin e imanit dhe

kuptimin e mallëngjimit për Allahun, *xhele shenuhu*. Ne duhet të mësohemi se si të turpërohemi prej Tij, si të mbështetemi tek Allahu, si t'i drejtohemi Atij. Në të njëjtën kohë duhet të krijojmë boshte rreth të cilëve do të tubohet rinia, e cila pastaj duhet të nxitet të aktivizohet në çdo veprimtari të dobishme shoqërore. Ata duhet të kuptojnë se ndihma që u ofrohet të tjerëve është kulmi i bamirësisë ndaj vetvetes. Le të jetë angazhimi në punë bamirësie mjeti i pastrimit shpirtëror dhe i shkëlqimit të imanit. Propozoj që në shkollat fillore mos t'u dorëzohen diplomat e tyre nxënësve pa i angazhuar në veprimtari të dobishme shoqërore për së paku dyqind orë pune, që në shkollat e mesme nxënësve mos t'u dorëzohen diplomat e tyre pa i angazhuar në veprimtari të dobishme shoqërore për së paku treqind orë pune, që studentëve në universitete mos t'u dorëzohen diplomat e tyre pa i angazhuar në veprimtari të dobishme shoqërore për së paku pesëqind orë pune.

Prej ligjëruesve që thërrasin në Islam dhe në vlerat e Islamit pritet që të fokusohen në qëllimin më sublim të ekzistencës sonë, qëllimin të cilin duhet të mundohemi ta realizojmë në këtë botë, të arrijmë tek pëlqimi dhe kënaqësia e Allahut, *subhanehu ue teala*. Më pëlqeu fjala e njërit prej mendimtarëve, i cili ka thënë se vazhdimisht para vendimeve të mëdha në jetën e tij ia kujtonte vetes vdekjen, që të mos e harrojë fundin e pashmangshëm dhe të mbetet i paluhatshëm me metodologjinë e drejtë hyjnore. ■

Përktheu: Talha Kurtishi



Shpeshherë të vjen keq kur i gjen muslimanët e aq më shumë thirrësit dhe zotëruesit e dijes, që merren me njëri-tjetrin duke u armiqësuar e bojkotuar për çështje në të cilat ka vend për më shumë se një mendim, sikur feja të mos ishte veçse në këto çështje dhe sikur armiqtë e vërtetë të mos ishin përveçse vëllezërit e tyre

SHKRUAN: BLEDAR TEFIK HAXHIU

Falënderimi i takon vetëm Allahut të vetmit në sundim, i cili është veçuar me adhurim dhe falënderim. Dëshmoj se Allahu është i vetmi Zot, e kush adhuron dikë tjetër veç Tij ka rënë në idhujtari dhe Atij i ka bërë shok, po ashtu dëshmoj se

Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, i cili idhujtarinë e ndaloi dhe njerëzit për të me ashpërsi i qortoi. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin për të, familjen, shokët dhe çdo kënd që Allahun të vetëm adhuron.

Kjo është një temë e rëndësishme, e cila duhet të jetë shqetësimi ynë i përhershëm dhe i vazhdueshëm, të jetë ilaçi që ne përdorim për rregullimin e gjendjes së

¹ Thelbin dhe idenë e kësaj teme e kam huazuar nga dy broshura thuajse me të njëjtin titull, njëra e muhadithit dhe dijetarit të madh imam Albanit, Allahu pastë rahmet për të, si dhe e dijetarit Nasir Umer Allahu e ruajt dhe e ndihmoftë.

muslimanëve dhe shërimin e plagëve të tyre, të cilët sot për fat të keq kanë rënë në shumë prej veprave të idhujtarëve tek të cilët u dërgua Profeti ynë Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem*. Por përse pikërisht kaq nevojë e përsëritur për këtë temë? Përse duhet t'i japim kaq rëndësi teuhidit? A duhet të shpenzojmë gjithë këtë energji për këtë temë?

Është normale për atë që lexon shpesh rreth kësaj teme dhe ende nuk e ka kuptuar rëndësinë e saj t'i parashtroj këto pyetje? Ndaj dhe ne në këtë temë nuk kemi si qëllim shpjegimin e detajuar të teuhidit, por vetëm të hedhim dritë në atë se teuhidi (njësimi i Allahut) është para së gjithash, ajo me të cilën duhet të fillojmë dhe e fundit me të cilën duhet të mbarojmë dhe do të mjaftojnë pikat që do të parashtrojmë për të nxjerrë në pah rëndësinë dhe vlerën e teuhidit.

1. Detyra që kemi për këshillën e muslimanëve, dhe në veçanti për thirrësit dhe kërkuesit e diturisë, sepse feja mbi të gjitha është këshillë.

2. Allahu i krijoi krijesat, zbriti librat dhe i dërgoi profetët pikërisht me teuhidin: ***"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë"***.² Pra, ta njësojnë.

3. Mos dhënia rëndësi Njësimi të Allahut, konsiderimi i tij si çështje dytësore, angazhimi me çështje të tjera, të cilat në realitet janë degë e Teuhidit.

4. Dobësimi dhe zbehja e gjurmëve të Teuhidit tek shumë prej bijve të këtij populli, madje humbja në tërësi tek disa prej tyre, për shkak të diktaturës së egër, e cila ndaloj të drejtën e besimit tek populli ynë, aq sa u rritën breza të privuar nga kjo e drejtë.

5. Përhapja e shumë prej fenomeneve të idhujtarisë, si dhe vepra të cilat e

shkatërrojnë fenë e individit dhe të shoqërisë, si magjia, ateizmi, madhërimi i varreve, tyrbeve dhe mekameve.

6. Ky umet nuk mund të rregullohet veçse me atë që u rregulluan të parët e tij, dhe vallë a nuk u rregulluan ata veçse duke i dhënë rëndësi teuhidit para së gjithash?!...

7. Përpjekjet e armiqve të fesë dhe kërkesat e tyre të njëpasnjëshme, që muslimanët të heqin dorë nga mësimi, studimi dhe praktikimi i teuhidit.

Pra shkaqet që na detyrojnë të rishkruajmë rreth kësaj teme janë të shumta, por nga më të mëdhatë është dhe ajo se nëpërmjet njësimi të Allahut dhe njohjes së Tij, fesë dhe Profetit, një popull mund të arrijë krenarinë e tij, në momentin kur njësojnë Zotin e tyre kanë për t'u çliruar nga prangat e idhujtarisë. E gjithë kjo më kujton Rebiatu ibën Amir, këtë sahab të veshur me rroba të arnuara, i cili shkon si mesazher tek Rustumi, komandanti³ i një prej ushtrive më të mëdha të asaj kohe. Kur Rustumi e pyeti se për çfarë kishin ardhur muslimanët në ato anë e çfarë kërkonin, ai me krenarinë më të madh iu përgjigj: Të nxjerrim njerëzit nga adhurimi i njerëzve për në adhurimin e Zotit të njerëzve, nga padrejtësitë dhe vuajtjet e feve (të kota), për në drejtësinë e fesë Islame dhe nga ngushtësia e kësaj bote, për në gjerësinë e ahiretit.

Përderisa ne të gjithë e kuptojmë tashmë, se në njësimin e Allahut gjendet forca jonë, se duke njësuar Atë arrihet krenaria jonë, se duke njësuar Allahun realizohet bashkimi dhe uniteti ynë, atëherë o burra të angazhohemi me të, duke e studiuar, duke thirrur njerëzit në të, duke botuar libra rreth tij. Le të jetë thirrja dhe përpjekja e të gjithëve neve së bashku -që

² Sure Dhariat: 56.

³ Nëse do të përkthehej me termat e sotme: Gjenerali i trupave perse.

njerëzit ta kuptojnë teuhidin e të punojnë me të-, sa koha dhe përpjekja e Profetit Nuh alejhi selam, i cili e thirri popullin e tij plot 950 vite për në fjalën e teuhidit dhe punimin me të, për në La ilahe ila llah (Nuk ka të adhruar tjetër me të drejtë veç Allahut). Po ashtu edhe Profeti ynë Muhamedi alejhi salatu ue selem e filloi thirrjen e tij me teuhidin kur i tha Kurejshve: *“Thoni la ilahe ila llah të shpëtoni”*.⁴ Dhe e mbaroi jetën e tij me teuhidin, kur iu drejtua muslimanëve me këto fjalë: *“Allahu i mallkoftë çifutët dhe të krishterët, ata i bënë varret e profetëve të tyre faltore,- e thoshte këtë si qortim për atë që bënë”*.⁵

Kështu që Teuhidi duhet të jetë para së gjithash, sepse ai është thirrja e të gjithë profetëve. Imam Ibën Kajimi –Allahu e mëshiroftë- ka thënë: *“Të gjithë profetët ftuan për në: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”*.⁶ Të gjithë ata ftuan për në njësimin e Allahut dhe singëritetin ndaj Tij në adhurim, dhe kjo nga i pari i tyre e deri tek i fundit. Nuhu i tha popullit të tij: *“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij!”*⁷ Të njëjtën gjë thanë edhe Hudi, Salihu, Shuajbi, Ibrahim i etj. Allahu thotë në Kuran: *“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”* po ashtu Allahu thotë: *“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!”*⁸ Më pas Ibën Kajimi ka përmendur se e gjithë feja kthehet tek surja Fatiha, sepse ajo përmban njësimin e Allahut me të gjitha llojet e tij.⁹

■ 4 Ahmed i hadithi është i saktë.

5 Buhari dhe Muslimi.

6 Fatiha: 5.

7 Araf: 59.

8 Enbija: 25.

9 Medarixhu Salikin i Ibën Kajim el Xheuzije vëll: 1.

10 Buhari dhe Muslimi, nga hadithi i Enesit.

“...Ky umet nuk mund të rregullohet veçse me atë që u rregulluan të parët e tij, dhe vallë a nuk u rregulluan ata veçse duke i dhënë rëndësi teuhidit para së gjithash?!...”

Profeti Muhamed sal-lallahu alejhi ue selem, kur e dërgoi Muadh ibën Xhebelin në Jemen e porosi duke i thënë: *“Ti do të shkosh në një popull prej Ithtarëve të Librit, le të jetë gjëja e parë në të cilën do t’i thërrasësh që të njësojnë Allahun”*. Në një transmetim tjetër: *“Të dëshmojnë se nuk ka të adhruar tjetër me të drejtë veç Allahut dhe se unë jam rob dhe i dërguar i Tij”*.¹⁰ Kështu që në shoqëritë tona ka rënë thuasë e njëjta sëmundje që kish rënë edhe në kohën e Profetit, ndaj dhe ilaçi që duhet të përdorim për kurimin dhe shërimin e tij duhet të jetë po i njëjti ilaç që përdori Profeti sal-lallahu alejhi ue selem, thirrja e njerëzve për në njësimin e Allahut, sepse siç ka thënë dhe imam Maliku: *“Nuk rregullohet fundi i këtij umeti, përveç se me atë që u rregullua fillimi i tij”*.

Shpeshherë të vjen keq kur i gjen muslimanët e aq më shumë thirrësit dhe zotëruesit e dijes, që merren me njëritjetrin duke u armiqësuar e bojkotuar për çështje në të cilat ka vend për më shumë se një mendim, sikur feja të mos ishte veçse në këto çështje dhe sikur armiqtë e vërtetë të

mos ishin përveçse vëllezërit e tyre! E në realitet ne kështu kemi lënë të qetë ata që na trokasën nëpër dyer për të na konvertuar,¹¹ apo ata që hedhin helmin e devijimit në popullin tonë për t'i devijuar e për të përmbushur ambiciet e tyre politike.¹²

E gjitha kjo duhet të na shërbejë si ndërgjegjësim me vetveten, si përkujtim e këshillë, se suksesi, mirësia, krenaria, uniteti, forca dhe rregullimi do të vijnë vetëm atëherë kur tek ne Teuhidi do të jetë para së gjithash. Por si mund ta vendosim Teuhidin në rend të parë? Në realitet përgjigja për këtë pyetje është tejet e gjatë, por ne do ta përmbledhim në disa pika shkurtimisht:

a)- Ta mësojmë Teuhidin me të gjitha pjesët e tij, ta kuptojmë atë e më pas ta praktikojmë. Imam Buhariu në një nga kapitujt e librit të tij të saktë ka thënë: Temë: Dija është përpara fjalës dhe veprës. Pastaj përmend fjalën e Allahut: ***“Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut! Kërko falje për gjynahun tënd...”***¹³ Imam Ebu Hanife ka thënë: “Të kuptuarit e Njësimit dhe i besimit është më i dobishëm, se të kuptuarit e dispozitave legjislative”.¹⁴

b)- Mësimdhënia e tij dhe thirrja në të. Padyshim që kjo është një nga çështjet e rëndësishme së cilës ne duhet t'i kushtojmë vëmendje, sepse nuk mjafton që ta mësojmë atë vetëm për veten tonë, porse duhet të dimë se nga frytet e dijes është edhe puna dhe thirrja në të.

Vërejtje: Pa dyshim që çështjen e mësimdhënies duhet ta marrin në dorë dijetarët, ata të cilët kanë dije të gjerë dhe kuptim të saktë, në mënyrë që të mos merret kjo iniciativë nga të painformuarit e

“...Ibën Kajimi ka përmendur se e gjithë feja kthehet tek surja Fatiha, sepse ajo përmban njësimin e Allahut me të gjitha llojet e tij...”

më pas të ketë pasoja negative në shoqëri.

c)- Dashuria e teuhidit, zotëruesve të tij dhe punuesve me të. Pra duhet të kultivojmë në zemrat tona, fëmijëve tanë, nxënësve tanë, dashurinë për teuhidin dhe zotëruesit e tij, t'i mbrojmë ata dhe nderin e tyre. Nga shenjat e dashurisë së teuhidit është dhe angazhimi i muslimanit me të, gëzohet me atë që realizon plotësimin e tij, dhe brengoset nëse shikon diçka që e cenon, si dhe përpiket ta ndihmojë përhapjen e tij dhe t'i kundërpërgjigjet kundërshtarëve të tij.

ç)- Bashkimi i muslimanëve në bazë të njësimit të Allahut. Nga shenjat më të cilat njihet Ehli Suneti uel Xhemati (Pasuesit e Sunetit dhe ruajtësit e bashkësisë) është se ata thërrasin në bashkimin e fjalës dhe unitetin e radhëve, si dhe largimin e zënkave dhe përçarjeve dhe Allahu thotë: ***“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!”***¹⁵ dhe gjëja më madhështore është që muslimanët dhe radhët e tyre të bashkohen rreth njësimit të Allahut dhe adhurimit të Tij të vetëm e pa shok. Së fundi nuk më ngelet gjë tjetër veçse të përsëris e të them: Teuhidi para së gjithash, o ju muslimanë. ■

¹¹ Dëshmitarë të Jehovahit, evangjelistë, ungjillorë, protestantë etj.

¹² Sikurse Rrafidat (shiat e Iranit) me fondacionet e tyre si Sadi Shirazi, Fondacioni i Kuranit etj.

¹³ Muhamed; 19.

¹⁴ Teuhid Euelen: 70.

¹⁵ Ali Imran: 103.

BIOENERGJIA

(SISTEMI ENERGJIK I TRUPAVE) DHE PRAKTIKAT E KURIMIT ME TË

Trupat tonë kanë natyrë të thellë elektrike. Çdo kurs fillestar anatomie e konfirmon një gjë të tillë. Zvarriti këmbët e tua mbi tepih dhe pastaj prek ndonjë artikull metal. Kështu mund të shohësh elektricitetin e qëndrueshëm të shkarkohet nga gishtat e tu

SHKRUAN: RIJAD MISINI

I tërë falënderimi dhe lavdërimi është për Allahun e Lavdishëm. Vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi vulën e profetëve, Muhamedin, familjen dhe të gjithë pasuesit e tij.

Duke u nisur nga parimi logjik se të gjykosim për diçka është pasojë e parafytyrimit të drejtë të tij, edhe ne në këtë artikull do të përpiqemi që nën dritën e këtij ligji të flasim në vija të përgjithshme mbi bioenerginë dhe disa pyetje madhore që lidhen me te, si dhe disa dilema që ndoshta mund ta devijojnë të kuptuarit e drejtë të fenomeneve që lidhen me të.

Trupat tonë kanë natyrë të thellë elektrike. Çdo kurs fillestar anatomie e konfirmon një gjë të tillë. Zvarriti këmbët e tua mbi tepih dhe pastaj prek ndonjë artikull metal. Kështu mund të shohësh elektricitetin e qëndrueshëm të shkarkohet nga gishtat e tu. Një gjë e tillë nuk do të ishte e mundshme po qe se trupi yt nuk do të

kishte natyrë elektrike. Po qe se prek stufën e nxehtë do të ndjesh menjëherë dhembje, ngaqë ajo transmetohet elektrikut nëpër nerva deri në tru. Dhembja udhëton me shpejtësinë e elektricitetit dhe ky është shkaku pse ti ndjen dhembje menjëherë. Mesazhet elektrike shkojnë vazhdimisht kudo në trup për ta informuar pandërprerë për gjerat që shkojnë në te. Pa këtë rrjedhë elektrike nuk do të mund të shihje, as të dëgjoje, as të ndjeje, as të shijoje e as të nuhasje.

Një tjetër argument lidhur me ekzistencën e elektricitetit (energjisë) në trup është edhe elektroencefalografi (EEG) dhe elektrokardiografi (EKG). EEG-ja regjistron aktivitetin elektrik të trurit, ndërkohë që EKG-ja regjistron atë të zemrës. Këto pajisje janë përdorur me dekada nga shkenca e mjekësisë dhe janë si ato që mbërthehen pranë pacientëve të vdekur në dramat spitalore, që mund t'i shohësh në TV. Kur ekrani ndal "sinjalet" pacienti është i vdekur. Sistemet tona elektrike janë thelbësore për shëndetin tonë fizik dhe psikik.



Në fakt civilizimi e di këtë prej mijëra vitesh. Diku rreth 5000 vite më parë kinezët zbuluan sistemin kompleks të qarqeve energjike që qarkullojnë nëpër trup. Këto vargje përcjellëse elektrike ose meridianë siç quhen ndryshe janë epiqendra e praktikave lindore të shërimit dhe formojnë bazat e akupunkturës së ditëve moderne dhe teknikave të ndryshme e të gjera të kurave. Fillet e para të këtyre zbulimeve mund t'i gjejmë në akupunkturë dhe shiatsu, si praktika të hershme të kurave që qenë zhvilluar përgjatë shekujve në Kinë dhe Japoni.

Eksperti i *Çi Kongut* mjekësor (ushtrimeve të shëndetit nga mjekësia kineze) me renome ndërkombëtare, **Hasan el-Bishel** (Arabi Saudite) nënvizon faktin, se nocioni i energjisë me këtë botëkuptim nuk është monopol i kulturës kineze, por edhe

mjekësia greke, indiane, arabe dhe ajo islame e kane konsideruar se kjo energji është jetike dhe esenciale për shëndetin e njeriut.

Dallimi në mes këtyre kulturave qëndron në faktin se mjekësia kineze është më e përpikta në shtjellimin dhe trajtimin e temave dhe praktikave me bioenergji, për shkak se kjo mjekësi është bazuar në esencë në përqendrimin e saj në studimin e kësaj energjie dhe lidhjen e saj me shëndetin e njeriut përgjatë shekujve. Ai nënvizon më tej faktin, se për bioenergjinë si botëkuptim kanë folur edhe Ibën Sina në “Kanuni i mjekësisë”, ku e ka emërtuar me nocionin “El-kuva uel-efal” (Fuqitë dhe veprimet), Imam Ibën Kajimi e emerton me nocionin “El-Harare el-Garizijje” (Nxehhtësia natyrale) në veprën e vet “Zad el-Mead (Et-Tibb en-nebeuij)”, dhe Ebu Hamid Gazaliu e emërton me nocionin “El-Buhar el-Letif” (Avulli

delikat).

Instituti Kombëtar Amerikan i Mjekësisë kërkoi nga kirurgu i kockave Dr. Robert Beker studime konkrete për të kuptuar metodikën e punës së akupunkturës. Supozimi fillestar i Dr. Bekerit ishte se ekzistenca e rrymave elektrike, që ai regjistroi në kërkimet e veta, në realitet është po e njëjta gjë që qarkullon nëpër meridianët e energjisë në të cilat bazohet mjekësia kineze në praktikat e akupunkturës dhe se ato meridianë në të vërtetë janë përçues elektrikë dhe pikat që ekzistojnë përgjatë atyre meridianëve shërbejnë si stacione stimulimi të kësaj rryme energjie, proces i cili realizohet me stimulimin e energjisë përmes nguljes së gjilpërave në ato pika. Rezultatet e Dr. Bekerit konfirmuan supozimet e tij dhe se pikat (lexo: meridianët), që i saktëson mjekësia kineze me përpikëri të madhe për të ngulur gjilpërat në to janë pika njëmend të sakta për stimulimin dhe forcimin e rrymës elektrike. Më në fund u bë e qartë se teoritë e mjekësisë kineze në lidhje me bioenergjinë dhe ndikimin e saj tek njeriu, u qartësuan shumë paqartësi përkitazi me mekanizmat e shërimit, të cilat hutuan studiuesit dhe profesionistët përgjatë shekujsh dhe se ato teori japin përgjigje konkrete dhe të sakta mbi forcat e brendshme të njeriut në avancimin e shëndetit dhe realizimin e tij, natyrisht me lejen dhe ndihmën e Allahut.

Një tjetër studim serioz dhe mjaft interesant është edhe studimi i Born Nordenstormit, shkencëtar suedez dhe ish-kryetar i Komisionit për Kandidim pranë çmimit Nobel. Ai në studimet e tij, që zgjatën dy dekada dokumentoi ekzistencën e qarkoreve elektrike në trup. Shkak i studimeve të tij ishte ekzistimi i një aure ndriçuese rreth një tumori malinj në mushkëri, gjë që e shtyu atë ta studiojë një dukuri të tillë.

“Por, a nuk ekziston rreziku i mbështetjes së zemrës në kura të tilla dhe si rrjedhojë të rrezikohet çiltëria e besimit Islam, apo rënia në kurthin e shirkut?!... ”

Ka edhe disa studime empirike mjaft konkrete, të cilat i sjell psikoterapeuti amerikan Dr. Roxher Kallahan në librin e tij “Tapping the Healer within”, por ne nuk e shohim të arsyeshme të zgjerohemi edhe më tej. Vlen të përmendet këtu edhe fakti se Organizata Botërore e Shëndetësisë në raportin e saj mbi mjekësinë popullore e ka regjistruar Çi Kongun Mjekësor (Ushtrimet e zhvillimit të energjisë) si një prej terapive natyrale nga mjekësia kineze dhe e ka përkufizuar kështu: “Çi Kongu mjekësor janë ushtrime nga mjekësia popullore kineze, ku inkuadrohen lëvizjet e shoqëruara me meditim dhe rregullimin e frymëmarrjes për forcimin e qarkullimit të bioenergjisë (çi) në trup, përmirësimin e qarkullimit të saj dhe forcimin e funksionit të imunitetit”.

Edhe disa qendra me renome ndërkombëtare e kanë inkuadruar Çi Kongun si strategji plotësuese në repartet e mjekësisë alternative, siç janë: Mayo Clinic; Qendra mjekësore në kuadrin e universitetit UCLA; spitali Stanford etj.

Në lidhje me debatin, se a thua vallë praktikat e kurave me bioenergji bien ndesh me besimin e pastër Islam, autori pati rastin të takohet edhe me Dr. Seid el-Gamidiun, ekspert i çështjeve akaidologjike dhe profesor në universitetin Umm el-Kura në Mekën e Ndërshe dhe me këtë rast diskutoi me te, në lidhje me praktikat e kurave me bioenergji. Ai konfirmoi ligjshmërinë e

shërimit me anë të këtyre kurave pas një studimi të hollësishëm të librit të ekspertit dhe terapeutit Hasan el-Bishel “Shëndeti nga brendësia jote”, duke mohuar se praktika të tilla bien ndesh me besimin Islam.

E pyeta: “Por, a nuk ekziston rreziku i mbështetjes së zemrës në kura të tilla dhe si rrjedhojë të rrezikohet çiltëria e besimit Islam, apo rënia në kurthin e shirkut?!”

Ai më tha se një rrezik i tillë ekziston gjithnjë edhe në praktikat e kurave me medikamente dhe teknikat e mjekësisë konvencionale! Nuk ka dallim këtu. Çështja qëndron këtu në realitetin e efikasitetit dhe ligjshmërinë e të shëruarit me të dy llojet e kurave, por gjithnjë duke u mbështetur tek Allahu i Madhërishëm në kthimin e shëndetit apo parandalimin e sëmundjeve, meqë të gjitha ato kura bëjnë pjesë në botën e shkaqeve materiale dhe energjike, dhe ne si muslimanë jemi të urdhëruar t’i bëjmë shkaqet dhe njëkohësisht zemrat tona të lidhen me Allahun e jo me ato shkaqe. Po qe se zemrat tona do të lidheshin dhe mbështeteshin në këto shkaqe materiale, atëbotë ne do të kishim rënë në shirkun e vogël. Kjo vlen për të gjitha shkaqet materiale të kësaj bote dhe në të gjitha fushat e jetës. Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm gjithnjë për ligjin e shkaqeve dhe pasojave, të ngërthyera tërësisht dhe të integruara në domosdoshmërinë e besimit e të tevekulit (të mbështeturit e vazhdueshëm tek Allahu).

Mbetet të thuhet në përmbyllje të këtij artikulli, se nuk ka vend për mohimin e rezultateve shkencore empirike dhe se ta pranosh ekzistencën e bioenergjisë nuk do të thotë të biesh ndesh me besimin e pastër Islam e as nuk do të thotë se po flasim për besëtytni dhe besime pagane, mu ashtu si nuk do të thotë se të pranosh ekzistencën e komunikimeve radiotelefonike është filozofi sektare, që buron nga krishterimi, apo se përdorimi i këtyre valëve elektromagnetike

“...Mbetet të thuhet në përmbyllje të këtij artikulli, se nuk ka vend për mohimin e rezultateve shkencore empirike dhe se ta pranosh ekzistencën e bioenergjisë nuk do të thotë të biesh ndesh me besimin e pastër Islam ...”

në telekomunikacion do të thotë, se beson në katolicizëm!

Fakti se botëkuptimet mbi bioenergjinë janë keqkuptuar dhe keqpërdorur nga disa besime të feve të Lindjes së Largët nuk do të thotë që ta mohosh ekzistimin e saj. Paganët kane adhuruar diellin, hënën, planetët dhe shume krijesa të tjera, por kjo s’do të thotë aspak, se ato krijesa nuk ekzistojnë ashtu siç është absurde të denoncohesh prej tyre apo t’i urresh ato. Të krishterët adhurojnë Isaun alejhis selam! Çifutët adhurojnë Uzejrin alejhis selam. A do të thotë kjo, se ne duhet si reagim ta mohojmë ekzistencën e tyre, apo të denoncohem nga ata?!... Ne nuk e adhurojmë Isain alejhis selam, as diellin, as planetët e as bioenergjinë. Ne adhurojmë vetëm Allahun, i Cili na krijoi neve dhe ato; dhe Ai është i vetmi që meriton të adhurohet. Duhet të dihet edhe fakti, se nuk ka energji kozmike në kuptimin e veprimeve hyjnore, apo mbikëqyrjes se kozmosit. Ky është një besim i kotë dhe i pavërtetë. Pra, ashtu siç nuk ka oksigjen me ndikime dhe veprime hyjnore, por pa te cilin nuk mund të jetojmë, po ashtu nuk ka energji me veprime dhe ndikime hyjnore, e gjithashtu pa të cilin nuk do të mund të jetonim! Ato janë elemente që Allahu i Lartësuar ua nënshtroi gjallesave

dhe njerëzve dhe i bëri shkaqe për vazhdimin e jetës. **Edhe një herë e përsëris:** Ne gjithmonë duhet të mbështetemi tek Allahu, Krijuesi i shkaqeve, por në të njëjtën kohë t'i bëjmë edhe shkaqet.

Vërejtje me rendësi: Të lejohej të shkosh për shërim te ndonjë terapeut me bioenergj, por më përpara duhet të plotësohen tri kushte esenciale: *Kushti i parë:* terapeuti me bioenergj të jetë i kualifikuar dhe i certifikuar nga qendra trajnuese përkatëse të pranuar zyrtarisht nga autoritetet përkatëse. *Kushti i dytë:* praktikat e terapeutit me bioenergj të jenë neutrale, në kuptimin e mos-cenimit të ndonjë parimi të akides dhe të sjelljeve islame. *Kushti i tretë:* pacienti musliman duhet të ketë bindje të paluhatshme, se shërimi është në Dorë të Allahut të Madhërishëm, ndërkohë që mjekësia energjike është vetëm shkak material i krijuar nga Allahu i Lartë, d.m.th. që zemra e tij kurrsesi nuk duhet të mbështetet në atë shkak, por vetëm te Krijuesi i shkaqeve.

Literatura e shfrytëzuar:

1-The EFT Manual – Emotional Freedom Techniques (Manual i teknikës së lirisë emocionale). *Autor: Gary Craig.*

2- Atlik Kuvvete esh-shifa bidahilik (Liroje forcën e shërimit nga brenda). *Dr. Roger Callahan dhe Richard Trubo.*

3- El-Afiye min dahilik (Shëndeti nga brendësia jote). *Hasan el-Bishel.*

4- El-ilaxh bi mesarat et-Takah (Kurimi me meridianët e energjisë). *Prof. Tam Edwards dhe Hamud el-Abri.*



NJË PISHTAR MË PAK MUHAMED XHEMIL ZEJNO (1925-2010)

Mori vesh se ata kanë një ders të veçantë në një shtëpi të caktuar, ku tuboheshin çdo javë dhe hoxha i tyre u ligjëron. Hoxha Zejno tregon se shkova tek ata me disa të afërmit e mi dhe pritëm derisa erdhi hoxha i tyre, i cili ishte dijetari i shekullit Muhamed Nasirudin Albani.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Shejhu i nderuar Muhamed Xhemil Zejno lindi në vitin 1344 h. (1925) në qytetin e Halepit të Sirisë. Rrjedh nga një familje me vullnet fetar, edhe pse ishin të ndikuar nga sektet e sufinjve si shumica e njerëzve të atij vendi në atë kohë. Me të arritur moshën dhjetë vjeçare prindërit e regjistruan në shkollën: “Shtëpia e hafëzëve” në të cilën mësoi për pesë vite me radhë. Gjatë kësaj kohe ai mësoi Kuranin përmendësh dhe u dallua në të dhe bashkë me memorizimin e tij mësoi mjaft mirë edhe shkencat e texhvidit-leximit rrjedhshëm dhe me rregulla të Kuranit. Pastaj regjistrohët në shkollën e Halepit “Fakulteti Përgatitor i Sheriatit”, ku studioheshin shkencat fetare dhe përkrah tyre edhe ato bashkëkohore dhe e përfundoi në vitin 1948. Në këtë shkollë, e cila më vonë shndërrohet në shkollë e mesme të fesë mësoheshin shumë lëndë të rëndësishme, prej tyre: teuhidi, tefsiri, fikhu hanefij, sintaksa, morfologjia, historia, hadithi dhe shkencat e tij, etj., kurse në anën tjetër edhe lëndët bashkëkohore nuk ishin të pakta, ku prej tyre vlen të përmendet: fizika, kimia, matematika, gjuha franceze, geometria etj.

Pasi përfundoi këtë shkollë u dallua shumë në shkencat fetare, ku edhe mori pjesë në garat që mbaheshin në dituri dhe përmes tyre zgjidheshin nxënësit më të mirë dhe u jepej mundësia për vazhdimin e shkollimit në Universitetin e Az’harit. Shejhu i nderuar në këtë garë zuri vendin e

“Ai gjatë tërë jetës vazhdoi të mësonte nga dijetarët e Shamit e pastaj edhe të tjerët, ndërsa më vonë u bë edhe njohës i mirë i librave të Ibën Tejmies, Ibën Kajimit, Muhamed ibën Abdulvehabit dhe të Albanit...”

parë e të gjithë garuesve ngado që ishin, por edhe pse u ftua të studioje në Az’har ai siç e përmend edhe vetë, për shkaqe shëndetësore nuk mundi të vazhdonte studimet. Mirëpo kjo gjë nuk ia shoi aspak ambiciet e kërkimit të diturisë. Ai gjatë tërë jetës vazhdoi të mësonte nga dijetarët e Shamit e pastaj edhe të tjerët, ndërsa më vonë u bë edhe njohës i mirë i librave të Ibën Tejmies, Ibën Kajimit, Muhamed ibën Abdulvehabit dhe të Albanit. Përfitoi dukshëm edhe nga shejh Ibën Bazi pasi i qëndroi afër në Mekë për vite me radhë. Pas shkollimit të mesëm fillon të punojë mësues në institutin për mësimdhënës në Halep, në të cilin punoi plot njëzet e nëntë vite me radhë.

Që në moshë të re ka qenë i dhënë pas diturisë, pjesëmarrjes nëpër ligjëratat dhe tregonte kujdes të veçantë në faljen e namazit me xhemat. Aq shumë merrte pjesë

nëpër tubime sa i ra në sy xhematit të ashtuquajtur Nakshibendi dhe një ditë shehu i tyre iu afrua shejhut Zejno dhe filloi ta mësonte rreth këtij tarikati. Vazhdoi ta mësonte derisa e detyroi me disa adhurime që ishin të kërkuara në këtë sekt, por tregon Shejhu- për shkak se isha shumë i vogël nuk munda t'i kryej adhurime të tilla pasi ishin shumë të rënda për mua, por megjithatë prapë vazhdoja me disa të afërt të mi të merrja pjesë nëpër tubimet e tyre, që i bënë në emër të adhurimit. Bërtitnin aq shumë dhe ngriheshin në këmbë, gjithashtu bënë gjeste, të cilat si fëmijë më tmerronin tërësisht.

Pasi u rrit pak nuk e habiste më ky sekt dhe nuk e ndiente veten rehat deri sa filloi ta kërkonte të vërtetën dhe u takua me xhematin e sektit tjetër sufij të quajtur Shadhili. Filloi të shkonte në derset, adhurimet dhe shehët e tyre, derisa filloi t'i kuptojë edhe ata, se vepronin pothuajse të njëjtat gjërat si edhe Nakshibenditë. Ajo që e habiti më shumë ishte fakti se nxënësit e tyre nuk kishin të drejtë ta kundërshtonin shehun edhe atëherë kur të gjithë e dinin se ai e ka gabim.

Më vonë filloi të afrohej edhe me Kadiritë, por në mexhliet e tyre shumë shpejt vërejti se bërtitnin dhe recitonin fjalë të cilat të gjitha ishin kufër. Kështu vazhdonin deri para sabahut dhe binin të flinin pa e falur namazin e sabahut, gjë kjo e cila e ftoi tërësisht prej tyre. Shejhu i nderuar provoi edhe xhematin Teblig, ku me ta doli disa herë fillimisht nëpër qytetin e tij të lindjes e pastaj edhe më larg, por brenda kufijve të shtetit të tij, megjithatë edhe tek ata vërejti shumë mangësi dhe u largua nga shoqëria e tyre.

Ajo që e habiste më shumë tek sufijtë përveç të tjerash ishte kërkimi ndihmë nga të vdekurit dhe konsiderimi i të vdekurve si ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut... Ai

“...Më vonë filloi të afrohej edhe me Kadiritë, por në mexhliet e tyre shumë shpejt vërejti se bërtitnin dhe recitonin fjalë të cilat të gjitha ishin kufër. Kështu vazhdonin deri para sabahut dhe binin të flinin pa e falur namazin e sabahut...”

tregon se një ditë duke biseduar me një sheh të këtyre sekteve ai po i thoshte se lejohej kërkimi ndihmë nga të vdekurit pasi sipas tij ata ishin evlija. E hoxha Zejno i tha: “Kjo nuk është e vërtetë pasi Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e këshilloi Ibën Abasin me fjalën: “Kur të kërkosh nga dikush kërkto vetëm nga Allahu.” Atëherë shehu i mllëfosur ia kthen: “Është e lejuar kërkimi ndihmë nga të vdekurit!” Por Shejh Zejno i tha: “Në çfarë argumenti bazohesh?” Ai ia ktheu: “Bazohem në faktin se halla ime sa herë që sëmuret kërkon nga sheh Sadi (“evlija” i vdekur i sufijve, të cilin e marrin ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut dhe i luten atij) shërim e unë kur e pyes a të bën dobi sheh Sadi ajo më thotë: “Sa herë i lutem atij ai ndërmjetëson për mua tek Allahu dhe më shëron”. Ky ishte argumenti i këtij “dijetari” sufi. Shejh Zejno tregon se me të dëgjuar këto argumente sa qesharake dhe tregime fëmijësh aq edhe të dhimbshme për këta njerëz të giorë vendosi të largohej nga të gjitha këto sekte. Para se të largohej i tha atij njeriu: “Ti je dijetar dhe ke harxhuar tërë jetën tënde duke lexuar libra, kurse

tani besimin tënd e ngre mbi bindjet dhe llafet e hallës tënde”. Hoxha nuk dinte nga t’ia mbante, mirëpo deshi Allahu e në fund të këtij debati me këtë njeri ai pasi nuk kishte argumente për ta mposhtur hoxhën e akuzoi me fjalët: “Ti ke ideologji vehabite dhe sa herë shkon në umre sjell këtu tek ne libra vehabish.”

Hoxha i nderuar thotë se me të dëgjuar këto fjalë nga ai më lindi një shkëndijë se ku duhej të hulumtoja për ta gjetur të vërtetën. Deri atëherë thotë Hoxha nuk dija asgjë për këta njerëz përveçse që dëgjoja nga të afërmit e mi, nga hoxhallarët e sufijve dhe nga injorantët se këta “vehabijtë” janë njerëz të këqij, të devijuar, nuk e duan Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk dërgojnë salavat për të, dhe shumë shpifje të tjera.

Hoxha menjëherë filloi të kërkonte në Siri ndonjë dijetar të ashtuquajtur nga të tjerët: “vehabi” dhe të shikonte se kush ishin ata. Mori vesh se ata kanë një ders të veçantë në një shtëpi të caktuar, ku tuboheshin çdo javë dhe hoxha i tyre u ligjëron. Hoxha Zejno tregon se shkova tek ata me disa të afërmit e mi dhe pritëm derisa erdhi hoxha i tyre, i cili ishte dijetari i shekullit Muhamed Nasirudin Albani. Ky me të hyrë në dhomë dha selam, i përshëndeti të gjithë duke ua kapur dorën, filloi nga e djathta, nuk i lejoi të ngriheshin në këmbë, ishte njeri plot qetësi, buzëqeshje dhe respekt. Filloi dersin me lutjet që i bënte Profeti në fillim të çdo dersi, dërgonte salavat për të sa herë që përmendej emri i tij dhe në fund prapë e përshëndeti atë siç i takon. Gjithashtu i la të pranishmit të pyesnin dhe të jepnin mendimet dhe sugjerimet e tyre, e në fund unë edhe pse kisha shkuar me plotë hamendje dhe dyshime mbeta i habitur nga ky njeri. Me të dalë nga ligjëratat e kuptova se çdo gjë që ishte thënë për këta njerëz ishte gënjeshtër

dhe vendosa të merrja pjesë në këto ligjëratat, si dhe të mësoja prej librave që m’i propozonte ky dijetar. Prej asaj kohe filloi të bëhej i njohur në mesin e besimtarëve të Shamit si njëri ndër dijetarët më të mëdhenj që luftonin shirkun, sektet dhe bidatet dhe vazhdoi në këtë mënyrë derisa vdiq.

Në vitin 1399 h. (1979 g.) në moshën 55 vjeçare shkon në Mekë për të kryer Umren dhe njoftohet me shejhun e nderuar Abdulaziz ibën Baz dhe pas disa takimeve dhe bisedave me të shejh Ibën Bazi kupton aftësitë e Muhamed Xhemil Zejnos dhe besimin (akiden) e tij të pastër dhe që e kishte larg nga çdo devijim i sufizmit, ku si shkak i këtyre gjërave rezultoi që ta emëronte mësues në Qabe gjatë sezonit të haxhit në po atë vit.

Shejh ibën Bazi pas haxhit e dërgoi në Jordani në qytetin Remtha, ku u emërua imam dhe ligjërues në Xhaminë Salahudin në të cilën u mësonte nxënësve Kuranin dhe teuhidin. Gjatë asaj kohe shkonte edhe nëpër shkollat të ndryshme dhe u shpjegonte rreth besimit të Ehli Sunetit, ku ligjëratat e tij patën ndikim të madh atje.

Pas një viti, më 1400 (1980 g.) erdhi prapë në Mekë për umre dhe u takua me një nxënës të Institutit Bamirës të Hadithit, i cili gjendet në Mekë dhe ky i kërkoi Shejhut që të vinte mësimdhënës në këtë Institut, pasi sipas tij Instituti kishte nevojë për profesorë sidomos në shkencat e Mustalah Hadithit. Shejhu me të dëgjuar këto fjalë e thirri në telefon drejtorin e këtij Instituti, i cili shprehu gatishmërinë për bashkëpunim, por kërkoi nga Shejhu që të merrte leje edhe nga shejh Abdulaziz ibën Bazi me ç’rast ky i fundit me të marrë kërkesën e shejh Muhamed Xhemil Zejnos menjëherë i shkroi drejtorit të Institutit një letër përmes së cilës kërkonte që Shejh Zejnon ta pranonte profesor në këtë Institut. Në këtë Institut ai dha mësim në shkencat e tefsirit, teuhidit,

Kuranit etj.

Gjatë dhënies mësim në këtë Institut, hoxhës së nderuar iu hapën rrugët për fillimin e shkrimeve të tij të begata. Edhe pse ai më parë ishte marrë me shkrime, por tani mundësia ishte shumë më e mirë, ku si rrjedhojë edhe shkroi librat dhe broshurat e tij të shumta, të cilat morën jehonë në të katër anët e botës, ku prej tyre përfituan shumë myslimanë dhe u përkthyen në gjuhë të ndryshme. Mund të themi se libri i parë që e shkroi pasi filloi punën në këtë Institut ishte ai me titull: “Seria e orientimeve Islame”, seri e cila arriti në më tepër se njëzet broshura.

Që nga vitin 1400 h. -1980 g. hoxha jetoi në Mekë dhe pak a shumë me sa kam kuptuar nga fjalët e tij të thëna direkt kur takohesha me të dhe rrija si me babanë tim, ai ishte përndjekur nga regjimi i sotëm i Sirisë dhe nuk kishte të drejtë kthimi në vendlindjen e tij. Në Mekë shumicën e viteve e kaloi në lagjen Azizije, një lagje mjaft e njohur edhe për haxhinjtë tanë shqiptarë, të cilët në shumicën e rasteve stacionohen në po këtë lagje. Aty e vizitoja dhe mbaj mend të ketë pasur një shtëpi mjaft modeste mu ashtu siç ishte edhe vetë, e modestinë e tij nuk kishte kush të mos e lakmonte. Gjithashtu mbaj mend se e vizitonin shumë njerëz dhe ata i mbante nga namazi deri në namazin tjetër, kurse pas namazit të dytë i vinin vizitorë, nxënës dhe hoxhallarë të tjerë, të cilët edhe këta qëndronin deri në namazin tjetër. Dy djemtë e tij i shihja gjithmonë duke qëndruar në dhomën e pritjes, ku më i madhi prej tyre rreth të pesëdhjetave njëkohësisht ishte edhe koordinatori dhe përgatitësi i librave të babait të tij. E vazhdoi davetin e tij, shkrimet dhe derset derisa vdiq ditën e Xhuma 1 Dhulkade 1431 (08 Tetor 2010) në moshën 86 vjeçare gjegjësisht 87 (sipas datës hixhri) pas

namazit të Jacisë, ku edhe po atë natë iu fal namazi i xhenazes në Qabe dhe u varros në varrezat e qytetit të Mekës. Në faljen e xhenazes së tij morën pjesë shumë besimtarë, dijetarë dhe njerëz të shquar. Por zemra edhe pse mërzhitet, syri loton, prapë themi: “Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi”

O Allah fale atë, mëshiroje, shpëtoje dhe nderoje me vend të mirë. Zgjerioja varrin dhe laje me ujë, akull dhe breshër; pastroje prej gjynaheve ashtu siç pastrohet rroba e bardhë prej ndyrësisë. Zëvendësoja shtëpinë me një shtëpi më të mirë, familjen me një familje më të mirë, bashkëshorten me një bashkëshorte më të mirë, O Allah fute atë në xhenet dhe ruaje nga dënimi i varrit! Amin.

Në vitet e fundit të jetës së tij hoxha jetoi në një varfëri të skajshme, ku pasi nuk mundi ta paguante qiranë e shtëpisë u detyrua të ndërronte shpesh vendbanimin. Si pasojë e kësaj varfërie përmendet se ai kishte shitur të gjithë librat e bibliotekës së tij vetëm që të paguante qiranë e banimit. Por për fat të keq ne jemi asi besimtarësh, të cilët kështu ua kthejmë dijetarëve tanë të mirat dhe diturinë që na e kanë dhënë dhe që na e lanë trashëgimi. Allahu na faltë.

Librat e tij: Librat e tij janë të shumta dhe arrijnë në dhjetëra sosh. Ky dijetar dallohet me shkrimet e tij të lehta, bindëse dhe të argumentuara shumë mirë. Shpesh në to pas argumentimit ai përdor edhe logjikën e thjeshtë; logjikë kjo pa filozofi brenda saj dhe e pranueshme nga çdokush që ka mend. Ai nuk zgjatet nëpër libra duke përmendur emra njerëzish, fjalë dhe mendime të shumta, por mjaftohet me ajete, hadithe dhe komente sa më të shkurtra të dijetarëve. Librat e tij janë të përhapura në botën mbarë dhe janë përkthyer në shumë gjuhë, siç janë: shqip, turqisht, boshnjakisht, anglisht, frëngjisht,

gjermanisht, bengali, indoneziane, urdu, rusisht etj. Prej librave të tij më të njohur do të veçoja duke përmendur këto:

- 1- Njohuri të rëndësishme rreth fesë.
- 2- Vlera e salavatit dhe selamit mbi Muhamedin njeriun më të mirë.
- 3- Buqeta me lutje, edukatë dhe dhikër për njerëzit e devotshëm.
- 4- Dëshmia e Islamit, fjala: La ilahe ilallah Muhamed resulullah
- 5- Namazi është shtylla e fesë.
- 6- Dispozitat e zekatit dhe të shitblerjes.
- 7- Si u udhëzova?
- 8- Si ta kuptojmë ndërmjetësimin (tevesulin).
- 9- Agjërimi i Ramazanit.
- 10- Haxhi i pranuar.
- 11- Ndërmjetësja mes të vërtetës dhe krijesave.
- 12- Sufizmi në peshojën e Kuranit dhe Sunetit.
- 13- Gabime shumë të përhapura.
- 14- Komentim dhe sqarim i kaptinave më të mëdha në Kuran.
- 15- Thirrja e shejhut Muhamedi ibën Adulvehab.
- 16- Vërejtje për Ihvanul musliminët nga devijimet e Tahanit.
- 17- Qartësim dhe vërejtje rreth librit: “Akideja e Ibën Kethirit”
- 18- Vërejtje nga fitneja e tekfirit.
- 19- Udhëzime Islame për përmirësimin e individëve dhe shoqërive.
- 20- Bazat e Islamit dhe të Imanit.
- 21- Akideja Islame prej Kuranit dhe Sunetit të saktë.
- 22- Disa nga virtytet e Muhamedit dhe edukata e tij profetike.
- 23- Si t’i edukojmë fëmijët tanë.
- 24- Mrekullia e Israsë dhe Miraxhit.
- 25- Thirrje drejtuar edukatorëve dhe edukatoreve.
- 26- Fisnikërimi që i bëri Islami gruas.
- 27- Dispozitat e duhanit dhe pirjes së tij sipas fesë dhe mjekësisë.
- 28- Si ta kuptojmë Kuranin.
- 29- Udhëzimi i besimtarëve drejt rrugëve të fitores dhe sundimit.
- 30- Forma e haxhit të Profetit, sal-lallahu alejhi ue selem.
- 31- Vërejtje të përgjithshme rreth librit: “Safvetu tefasir”
- 32- Vërejtje të rëndësishme rreth librave: “Kurretul ajn” dhe “Tefsir xhelalejn”
- 33- “Seria e orientimeve Islame”
- 34- Tregime të çmuara profetike.
- 35- Grupi i shpëtuar dhe pala e ndihmuar.

Këto janë disa nga librat më kryesorë të shejh Muhamed Xhemil Zejnos me të cilat është për t’u habitur se sa kanë pasur jehonë të madhe në botë. Ndërsa më të njohurat në mesin tonë, pra tek shqipfolësit është libri i tij: “Grupi i shpëtuar dhe pala e ndihmuar”, si dhe ai u bë i njohur edhe me fletushkën: “Besimi i çdo muslimani”, që është në formë pyetje-përgjigje dhe çdo përgjigje ka ajetin dhe hadithin me të cilin argumentohet. ■

Allahu e mëshiroftë!



TRASHËGIMIA E FEMRËS NË ISLAM 2/2

Një grup orientalist morën guximin për ta sulmuar islamin, sikur Islami nuk ia jep të drejtën gruas ashtu sikurse burrit dhe bën diskriminim gjinor. Me këtë mashtruan veten, kur menduan se me këtë ata gjetën një padrejtësi në Islam, ku për shkak të kësaj njerëzit do të largohen apo do të mbjellin dyshime tek vetë myslimanët. Por harruan se me këtë ata shpalosën injorancën dhe paaftësinë e tyre

PËRGATITI: RASHIT ZYLFIU

Një nga akuzat që i atribuohet Islamit është edhe çështja e pabarazisë së femrës me mashkullin në çështjen e trashëgimisë, duke thënë se Islami i ka dhënë mashkullit hise sa për dy femra. Ata deklarojnë duke thënë, se edhe pse kjo mund të justifikohet me të kaluarën, ngase puna e femrës kryesisht ka qenë brenda shtëpisë, sot ajo konsiderohet partner i

mashkullit në të gjitha veprimtaritë dhe është e barabartë me të në të gjitha shpenzimet. Përse Islami e ka bërë një ndarje të tillë ndërmjet tyre?!... Në bazë të argumenteve për sa i përket trashëgimisë së femrës në Islam e drejta e saj përballë asaj se çfarë i takon ndryshon varësisht nga gjendja e saj. Në këtë pjesë do të paraqesim gjendjet e trashëgimisë së femrës.

Rastet kur femra dhe mashkulli janë të barabartë në të drejtën e trashëgimisë:

Le të sjellim vetëm tre shembuj kur femra është e barabartë me mashkullin, ndërkaq ka shembuj edhe më shumë se sa këto që do të përmendim:

Nëse i vdekuri ka lënë fëmijët, babanë dhe nënën. Prindërit, respektivisht babai dhe nëna, marrin 1/6 e pasurisë pa dallim ndërmjet burrërisë së babait dhe feminitetit të nënës, duke u bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“...për prindërit, për secilin nga ata, ju takon e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri), nëse ka fëmijë.”**¹

Nëse i vdekuri ka lënë vëllanë dhe motrën nga nëna dhe këta të dy nuk ka kush i pengon nga trashëgimia, atëherë secili prej tyre merr 1/6, duke u bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“...po ka një vëlla ose një motër (nga nëna), atëherë secilit prej tyre u takon një e gjashta.”**²

Nëse i vdekuri ka lënë dy e më tepër vëllezër nga nëna dhe dy e më tepër motra nga nëna, atëherë vëllezërit bashkërisht trashëgojnë 1/3, ndërsa motrat trashëgojnë 1/3.

Pra, pa pasur dallim mashkull ose femër duke u mbështetur në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“e në qoftë se janë më shumë (se një vëlla ose se një motër) ata janë pjesëmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë).”**³

Rastet kur femra merr shumëfish në të drejtën e trashëgimisë:

Le të sjellim dy shembuj kur femra merr shumëfish më tepër se mashkulli, kurse

“Kur vendosën për barazinë në trashëgimi ata e ngarkuan femrën edhe me punë dhe shpenzimin e pasurisë për vete dhe fëmijët e saj, e ngarkuan me atë që nuk mund ta mbajë...”

shembuj kemi edhe më shumë se këto:

Nëse gruaja e vdekur ka lënë bashkëshortin dhe një vajzë. Në këtë rast vajza e së vdekurës trashëgon gjysmën e pasurisë kurse babai i saj, respektivisht bashkëshorti i së vdekurës, trashëgon një të katërtën. Prandaj në këtë rast femra trashëgon dyfishin e asaj që trashëgon mashkulli.

Nëse i vdekuri ka lënë bashkëshorten, dy vajza dhe një vëlla të tij. Në këtë rast bashkëshortja merr të tetën e pasurisë, vajzat dy të tretat, ndërsa ajo që mbetet i takon xhaxhait të vajzave, respektivisht vëllait të të vdekurit. Kësisoj, secilës prej tyre u takon më shumë sesa i takon xhaxhait. D.m.th. secilës i takon kuota 8/24, ndërsa xhaxhait 5/24.

Dyshimet rreth trashëgimisë së femrës në Islam dhe përgjigjet rreth tyre:

Një grup orientalist morën guximin për ta sulmuar islamin, sikur Islami nuk ia jep

¹ Nisa, 11

² Nisa, 12

³ Nisa, 12.

⁴ Nisa, 11.

të drejtën gruas ashtu sikurse burrit dhe bën diskriminim gjinor. Me këtë mashtruan veten, kur menduan se me këtë ata gjetën një padrejtësi në Islam, ku për shkak të kësaj njerëzit do të largohen apo do të mbjellin dyshime tek vetë myslimanët. Por harruan se me këtë ata shpalosën injorancën dhe paaftësinë e tyre për t'i konceptuar gjërat drejt dhe nxorën në pah pretendimet e rrejshme të drejtësisë dhe profesionalizmit të tyre.

Islami thotë për trashëgiminë: ***“Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra;...”***⁴

Pyetje: Pse kjo ndarje? Çfarë drejtësi ka në te? A çdo herë mashkulli merr hise sa dy femra?

Përgjigje:

- Ligji mbi trashëgiminë në Islam është ligj që në të ka urtësi dhe drejtësi. Çdo kujt ia ka dhënë të drejtën aq sa i takon sipas afërsisë me të vdekurin (nga i cili trashëgohet).

- Këto akuza që i bënë orientalistët perëndimorë Islamit, se Islami është fe e prapambetur dhe nuk ka mundësi që njeriu (myslimani) t'i përshtatet botës moderne nëse merr Islamin si model të jetës së tij. Kjo është një akuzë e pabazë, mizore nga shumë aspekte:

- Barazia gjinore mes mashkullit dhe femrës është vetëm një formulë me të cilën bëhen eksperimente, por a ka mundësi në realitet apo ende nuk ka rezultate dhe po shohim sinjalet e dështimit, ngaqë femrën e kanë nxjerrë nga natyrshmëria e saj dhe duan ta ngarkojnë me diçka që ajo nuk ka mundësi për ta mbajtur. Kur vendosën për barazinë

“...Femra merr një të tretën që të shpenzojë vetëm për veten e saj, kurse mashkulli dy të tretat që të shpenzojë fillimisht për bashkëshorten (grua), pastaj për familjen dhe fëmijët e tij...”

në trashëgimi ata e ngarkuan femrën edhe me punë dhe shpenzimin e pasurisë për vete dhe fëmijët e saj, e ngarkuan me atë që nuk mund ta mbajë. Këtu ka padrejtësi mbi femrën, ngase vetë dalja e saj nga shtëpia për punë e ve përballë me shumë sfida dhe për këtë ka shumë dëshmi.

- Ndarja e trashëgimisë në ligjin islam nuk bëhet për shkak të burrërisë apo feminitetit, por për shkak të detyrave që ka secili. Gjithashtu merret në konsideratë edhe nevoja e trashëgimtarit, lloji i lidhjes ndërmjet tij dhe pasardhësve. Pra, çështja është absolutisht ekonomike.

- Situatat në të cilat ligji islam i ka dhënë më tepër mashkullit sesa femrës nuk janë thjesht pa dobi, por për shkak të pozitës së tij për sa i përket shpenzimit familjar. I zoti i shtëpisë merr përsipër mbikëqyrjen dhe shpenzimin për familjen e tij. Sistemi bashkëkohor, më saktësisht ai amerikan bën ndarjen e trashëgimisë sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet bashkëshortëve para vdekjes. S'ka dyshim se në këtë sistem ka padrejtësi, ngaqë ai nuk i merr parasysh detyrat individuale për të dy gjinitë.

Trashëgimia është çështje llogarie e jo

çështje ndjenjash e pretendimesh. Femra merr një të tretën që të shpenzojë vetëm për veten e saj, kurse mashkulli dy të tretat që të shpenzojë fillimisht për bashkëshorten (grua), pastaj për familjen dhe fëmijët e tij. Pra, kush merr më tepër me logjikën e llogaritjes dhe logjikën e numrave? Ekzistojnë edhe raste të pazakonshme për mashkullin, i cili tërë pasurinë e shpenzon për veten, nëse nuk martohet dhe nuk krijon familje, mirëpo ato janë raste të rralla. Kjo për sa i përket çështjes së pasurisë së trashëguar pa u lodhur.

Ndarje e drejtë nga ana e Allahut të Lartësuar, i Cili u jep **“secilit sipas nevojës”**, kurse peshorja e nevojës këtu nënkupton detyrimet e obliguara të secilit prej tyre. Ndërsa për sa i përket pasurisë së fituar me të gjitha format e saj, si shpërblimi për punën, fitimin në tregti, nuk ka dallim ndërmjet mashkullit dhe femrës, ngase këtu peshohet me peshore tjetër e ajo është barazia ndërmjet angazhimit dhe shpërblimit. Gjysma e asaj që merr mashkulli më tepër se femra në disa raste është thelbi i drejtësisë, ngase pasuria e mashkullit do të pakësohet përmes mehrit dhe shpenzimeve familjare, ndërsa pasuria e saj do të rritet me mehr dhe investim, nëse ajo investon. Shumica e vendeve skandinave akoma vazhdojnë të bëjnë dallim në trashëgimi ndërmjet mashkullit dhe femrës. Mashkullit i japin më tepër sesa femrës, përkundër barazisë së tyre në detyrime dhe përgjegjësi materiale.

Femra në Islam të drejtën trashëgimore e meritoi pa kryengritje dhe pa konferenca kurse femrat në botë e arritën këtë si

“Femra në Islam të drejtën trashëgimore e meritoi pa kryengritje dhe pa konferenca kurse femrat në botë e arritën këtë si rezultat i grevave dhe konferencave të shumta...”

rezultat i grevave dhe konferencave të shumta. Prandaj nuk është çështja e burrërisë dhe e feminitetit, mirëpo varësisht nga pozita dhe përgjegjësitë që ka secili prej tyre.

Islami e refuzon dhe e lufton parimin e privimit të femrës nga trashëgimia thjesht për shkak të feminitetit të saj, ose për shkaqe të cilat i përmendëm më sipër. Islami i ka caktuar asaj kuotën në të gjitha rastet e trashëgimisë. Islami e kundërshton edhe parimin e barazisë absolute ndërmjet asaj dhe mashkullit në trashëgimi. Ai në këtë drejtim ka vënë rregulla prej të cilave nuk duhet të dalim. Ky ishte një punim në version të shkurtuar mbi trashëgiminë e femrës në Islam, edhe pse jemi të kufizuar për të shkruar mbi këtë shkencë, që është një kapitull i gjerë në Sheriatin Islam. Allahu e di më së miri. ■

Referencat e konsultuara:

Tahkikat el-merdiye , Salih Feuzan.

Fikul Islami , Uehb Zuhjeli.

Ahkam mirath fi fikul islamij.

www.klubikulturor.com “Trashëgimia e femrës në Islam” Elmedin Ejupi.

KLAUZOLA NDËSHKUESE OSE GJOBA E VONESËS



Nëse këto kushte plotësohen në një kontratë, shumë nga dijetarët bashkëkohorë lejojnë të vendoset ky kusht i shpagimit, në kontratat e punës ku detyrimi nuk është para, pra në ndërtimtari, transport, punë, prodhim etj

Klauzolë sipas fjalorit të gjuhës shqipe është “Secila prej pikave të veçanta të parashikuara në një traktat, në një marrëveshje, në një kontratë etj.; dispozitë e veçantë që u shtohet neneve të një traktati, të një marrëveshjeje etj.” Ndërsa ndëshkimi është “Masë dënimi që merret kundër dikujt për një faj.” Ajo që kemi si qëllim me këtë studim nuk është larg nga kuptimi gjuhësor

përveç që në ekonominë islame kjo i nënshtrohet rregullave dhe dispozitave të veçanta, të cilat do të sqarohen në vijim.

Ky togfjalësh në terminologjinë e ekonomisë islame do të thotë: “marrëveshje e shtuar në kontratë në mes dy palëve kontraktuese për paracaktimin e gjobës në rast të dëmtimit të njëres palë nga moskryerja e detyrës së caktuar ose vonimin e

saj nga pala tjetër.”

Klauzola ndëshkuese mund të hyjë në të gjitha kontratat si p.sh. në:

-Kompanitë e ndërtimit, ku t'i kushtëzohet kontraktuesit, nëse nuk e kryen shtëpinë, ndërtesën etj., deri në këtë datë, për çdo ditë ose javë vonesë gjoba është kaq.

-Ndërmarrjet të cilat u kushtëzojnë punëtorëve nëse nuk janë të përpiktë në punën e tyre u hiqet nga rroga një sasi e caktuar.

-Kontratat e transportit, ku kushtëzohet arritja e mallit në ditën e caktuar përndryshe për çdo vonesë ndëshkohet me gjobë.

-Në prodhimtari, ku nëse një produkt i caktuar nuk kryhet me kohë ose ka defekte ndëshkohet me gjobë.

-Ndëshkimin e qiraxhiut në mosdorëzimin e banesës në afatin e caktuar.

-Si dhe në kontratat e borxhit qoftë borxhi hua direkt, ose borxh nga ndonjë shitblerje, ku kushtëzohet se: nëse vonohet borxhi tej afatit të caktuar apo kështu i skadon afati, atëherë ndëshkohet me gjobë të caktuar.

Këto që përmendëm nuk janë të lejuara të gjitha, por kanë dispozita të veçanta, të cilat do të sqarohen në vijim. Për të gjitha këto që përmendëm ndëshkimi mund të jetë gjobë në të holla, që është më e zakonshme, por mund të jetë edhe mangësi e detyrimit ndaj kontraktuesit, ose mund të jetë anulimi i afatit të kësteve, madje mund të jetë edhe ndëshkim moral, duke e shpallur në ndonjë gazetë ditore, ose duke vendosur emrin e punëtorit në listën e punëtorëve të papëlqyer etj. **Cilat janë arsytet pse njerëzit janë dhënë pas këtij kushti me të madhe në kohën tonë?**

1. Vlëra e madhe e kohës në kontratat bashkëkohore, ku vonimi i njëres palë kontraktuese i shkakton dëme të mëdha

palës tjetër në kohën dhe pasurinë e saj.

2. Çmimi i lartë i projekteve, gjë që vonesa ose mos-kryerja e tyre shkakton humbje të mëdha për palën kontraktuese.

3. Zgjerimi i rrethit tregtar, ku sot kontratat bëhen në largësi të mëdha dhe përballen me rreziqe të mëdha, kështu që detyrohen për kësi lloj klauzolash për t'i dhënë palës tjetër një lloj sigurie.

4. Përhapja e madhe e moskorrektësisë në zbatimin e detyrimeve të kontraktuara.

Disa dobi që sjell kjo klauzolë, gjë që i bën njerëzit t'i japin rëndësi më shumë:

a. I jep siguri kontraktuesit për kryerjen e punës së caktuar pa e vonuar ose pa defekte, si dhe e siguron palën tjetër për zbatimin e detyrimit në kohë.

b. Shmang mospajtimet e mundshme rreth shpagimit të dëmit duke qenë se në këtë klauzolë paracaktohet shuma sipas marrëveshjes, të cilën duhet ta paguajë pala dëmtuese.

c. Kursen harxhimet dhe kohën të cilën do ta kishin shpenzuar nëpër gjykata në rast të mungesës së kësaj klauzole.

Kushtet të cilat duhet të plotësohen për t'u zbatuar klauzola ndëshkuese:

1. Bërja e gabimit (vonimi, moskryerja, kryerja me defekte) nga pala kontraktuese. Nëse nuk bën ndonjë gabim atëherë nuk zbatohet kjo marrëveshje.

2. Dëmi i vërtetë i cili i ndodh palës tjetër, nëse me gabimin ose vonesën e palës tjetër nuk i ndodh asnjë dëm material, atëherë nuk vjen në shprehje kjo marrëveshje.

3. Dëmi të ketë ndodhur si rezultat i gabimit të kontraktuesit, nëse dëmi është nga ndonjë faktor i jashtëm, që nuk ka të bëjë me kontraktuesin kjo marrëveshje nuk zbatohet.

Nëse këto kushte plotësohen në një kontratë, shumë nga dijetarët bashkëkohorë lejojnë të vendoset ky kusht i

shpagimit, në kontratat e punës ku detyrimi nuk është para, pra në ndërtimtari, transport, punë, prodhim etj. Argumentet që e mbështesin këtë mendim janë:

-Fjala e Allahut “O ju që keni besuar zbatoni kontratat.” Maide: 1.

-Fjala e Lajmëtarit të Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të: “Muslimanët duhet t’iu përmbahen kushteve të parashtruara.” (Ebu Davudi, Albani sahih.)

-Në esencë gjërat janë të lejuara përderisa të kemi ndonjë argument, i cili e ndalon atë, që në këtë rast nuk ka ndonjë argument të qartë.

-Tradita tregtare në kohën e sotme dhe përderisa kjo traditë nuk bie ndesh me ndonjë parim fetar, atëherë duhet të merret në konsideratë.

Ndërsa një pjesë tjetër e dijetarëve nuk e lejojnë kurrsesi vendosjen e këtij parakushti. Ata thonë: nëse me të vërtetë ndodh dëmi, atëherë kjo çështje shqyrtohet në gjykatë dhe merret vendimi përkatës.

E gjithë kjo për ti ikur paracaktimit paushall, sepse nuk dihet saktësisht sa mund të jetë dëmi dhe zakonisht paracaktohet një shumë më e madhe se ajo që kërkohet në realitet. Për këtë kur dijetarët e Komisionit për Fetva në Arabinë Saudite lejuan një parakusht të tillë, theksuan se nëse shumë e paracaktuar është e stërmadhe, atëherë ky kusht duhet të reduktohet në bazë të rregullave shariatike, që të përputhet me realitetin sa më shumë që është e mundshme.

Ndërsa sa i përket detyrimeve që janë para, pra hua direkt ose pagesë e mallit të afatizuar, nuk lejohet kurrsesi të vendoset ky kusht, sepse një gjë e tillë është kamatë e qartë, e cila është e ndaluar rreptësisht në Kuran dhe Sunet.

Dijetarët kanë lejuar me rastin e borxhit të afatizuar në këste, të vendoset klauzola, e

“Ndërsa sa i përket detyrimeve që janë para, pra hua direkt ose pagesë e mallit të afatizuar, nuk lejohet kurrsesi të vendoset ky kusht, sepse një gjë e tillë është kamatë e qartë, e cila është e ndaluar rreptësisht në Kuran dhe Sunet...”

cila thekson që: “nëse nuk i paguan këstet me radhë në afatin e caktuar do të anulohet afatizimi i kësteve të tjera dhe detyrohet me pagesën e menjëhershme të borxhit”, por pa shtuar në vlerën e borxhit.

Duhet theksuar se disa borde shariatike të disa bankave islame kanë lejuar të kushtëzohet gjoba e vonimit edhe për borxhet në të holla, nëse ato vonohen nga afati i caktuar, por kjo gjobë e marrë prej konsumatorëve të mos shpenzohet në interesat e bankës, por të shpërndahet në sfera humanitare. Një mendim të tillë shumë dijetarë bashkëkohorë e refuzojnë plotësisht, duke konsideruar se kamata nuk lejohet as për qarqe humanitare nëse bëhet me paramendim.

Përfundimisht themi: lejohet klauzola ndëshkuese, në kontratat në të cilat detyrimi nuk është në të holla, pra në kontrata pune, ndërsa në rastin e skadimit të afatit të borxhit nuk lejohet kurrsesi vendosja e klauzolës ndëshkuese, për gjobë të caktuar, ndonëse lejohet kushtëzimi i anulimit të afatit të kësteve të pa-skaduara. ■

NË KUJTESËN E FËMIJËS TËND... SHKRUAJ HISTORI ME TË CILËN DO TË MBURRET



Çdo kujdestar i një grupi individësh apo i një bashkësie e ka për detyrë që të kujdeset për shëndetin e kësaj kujtese, për ta mbrojtur nga çdo devijim, keqinformim, keqpërdorim dhe dëmtim, apo nga cenimi i të drejtave të saj dhe i paprekshmërisë së saj, sepse ajo kujtesë përbën regjistrin e brezave të ardhshëm, regjistrin e burrave dhe grave që nesër do të marrin në dorë poste ku merren vendime mbi të cilat do të ndërtohet një umet politikisht, nga ana arsimore, ekonomike etj.

SAFIJE UEDGAJRI

Kujtesa e njeriut është ajo depozitë e madhe brenda së cilës renditen letrat dhe dosjet e tua. Ajo është libraria jote e gjerë, e cila përfshin enciklopeditë e tua shkencore dhe librat e tua me vlerë të rrallë.

Ti je ai që i rendit ato herë pas here dhe po ti i vendos ato në pasqyrën e lëndës sipas tematikave të veçanta, sipas llojeve të ndryshme dhe sipas numrave të tyre rendorë në ngjitje. Sa herë që ditët dhe vitet ndjekin njëri-tjetrin edhe depozita e memories rritet në përmbajtjen e saj dhe raftet e saj shtohen e mbushen. Sa herë që

depozita dhe biblioteka jote është e mbushur me libra dhe enciklopedi me vlera shkencore, me histori të lashtë dhe burimore, aq më shumë ajo fiton vlerë dhe përfaqëson një trashëgimi, që duhet t'u lihet pas brezave, mbetet e përjetshme për t'u sjellë dobi njerëzve dhe vepra jote bëhet një vepër që nuk ndërpritet pas vdekjes.

E kundërta do të ndodhte nëse depozita e kujtesës tënde dhe biblioteka jote do të kishin qenë bosh, me rafte të pakta, në të cilat nuk gjendet gjë tjetër veç disa letrave të shpërhapura dhe regjistrave që qëndrojnë sipër njëri-tjetrit, disa lapsa aty-këtu dhe libërtha, histori dhe tregime të kota, vlera e të cilave janë vetëm disa çaste të leximit të tyre për argëtim, apo për të kaluar kohën e lirë, gjëra për të cilat do të përfshihen në llogarinë tënde më vonë. Me një bibliotekë të tillë ti ke turp që në derën e saj të hyjë njeri tjetër përveç teje, që të zbulojë mungesën e rregullsisë dhe të rendit, shijen tënde të prishur dhe devijimin e natyrës tënde. Kështu mund të të bjerë vlera dhe pozita, ashtu siç bie edhe vlera e depozitës dhe e bibliotekës tënde.

Ajo nuk është gjë tjetër veçse një vend ku ti fsheh hedhurinat e tua dhe objektivat e tua të pavlera, apo letrat e vjetra dhe regjistrat e sekreteve të tua. Kështu kalojnë ditët dhe vitet nga jeta jote, derisa të vijë momenti që ta urresh atë depozitë dhe të vendosësh në një moment zgjimi të mendimit tënd dhe të pjekurisë së ndjesisë tënde, që ta hedhësh tej dhe ta flakësh me gjithçka ka brenda në koshin e plehrave, ose ta përdorësh gërmadhën që ka mbetur prej saj për të ndezur zjarrin që të kthehet në flakë për drunjtë. E tillë është edhe depozita e kujtesës tënde. Në të gjenden dosje dhe regjistra, që e meritojnë të mbeten të përjetshme, që t'i përkujtosh dhe të jetojë ditari i saj me mburrje dhe krenari. Nga ana tjetër ka syresh prej të cilave të kap frika

“...Ne nuk e kuptonim rrezikun e veprave, përvojave dhe veprimeve tona, as rrezikun e fjalëve që shqiptonim me gjuhën tonë. Ne i lëshonim frerët pa asnjë litar për të na mbajtur lidhur...”

apo ke ndrojtje sa herë që i rikthehesh, apo kur dikush tjetër përveç teje përpiket që t'i nxjerrë ato jashtë.

Por ne kur ishim fëmijë nuk zotëronim një pjekuri në mendim, që të na nxiste të tregoheshim të kujdesshëm prej kategorive dhe temave që duhet të mbante kujtesa jonë, ashtu siç veprojmë kur ndërtojmë një depozitë për bibliotekën tonë. Ne nuk kishim mundësi të merrnin një vendim të saktë, sepse ende nuk e kishim mbushur moshën e pjekurisë dhe moshën që të na jepte mundësinë për të dalluar gjërat. Në këtë mënyrë ne ishim të pafuqishëm për të zgjedhur atë që na përshtatej dhe që përkonte me shijet tona, apo që të kishim mundësi të ngrinin lart nivelin tonë për të parë me syrin vizionar, ashtu siç shohim sot, që jemi të mëdhenj pamjen e të vërtetës, e cila fshihet nga pluhuri i dendur që përhapej rreth nesh nga jeta jonë ende e mbetur në moshën e fëmijërisë. Kështu ne kemi nevojë për shumë vite që të na forcohej kuraja, të na rritej ambicia, të rriteshin brenda nesh vlerat dhe mendimet, e bashkë me mendjet tona të rriteshin edhe qëllimet e objektivat.

Kur ishim fëmijë të vegjël ne nuk e kishim në dorën tonë që të regjistronim në kujtesën tonë me zgjedhjen dhe me

vendimin tonë të lirë, atë që e meritonte të përjetësohej në brendësi të kokave tona të vogla, apo të ruhej në depozitën e kujtesës sonë të re. Ne ishim në etapën e imitimit dhe jo në etapën e krijimit të ideve. Identiteti ynë ishte ende i thjeshtë, preokupimet tona nuk ishin të mëdha, ëndrrat tona i përziem me një imagjinatë që kishte hapësirë të ngushtë, në ngjyrat e natyrës ne vendosnim shenjat e pikturimit të saj me një furçë që në duart tona ishte tepër e ndrojtur dhe e pavendosur. Ne nuk lindëm të ditur dhe intelektualë, as nuk arrinim të dallonim dhe të kuptonim oqeanin e botës në të cilën jetonim, as nuk arrinim dot të zbulonim të fshehtat dhe sekretet e saja të shumta, të cilat i tejkalonin mundësitë e botëkuptimit tonë.

Ne ishim ende të vegjël dhe ende nuk ishim ndarë nga kalimi i disa orëve nga jeta jonë me lojëra e dëfrime, sepse orët tona nuk i vendosnin para nesh por pas nesh, nuk kujdeseshim që ballin tonë ta zbukuronim me ato orë, as që t'i lidhnim ato në mur, apo t'i vendosnin në raftet e larta dhe që të na kujtonin sesa kohë kishte kaluar dhe sa kishte mbetur. Në atë periudhë orët nuk kanë asnjë vlerë, as koha që na shkonte dhe na mbaronte. Në atë periudhë kohët tona ishin një pronë e jona, të cilën e shpenzonim me shumë bujari dhe as nuk mendonim për ditën që do të vinte më pas, madje i jetonim çastet tona ashtu siç ishin.

Ne nuk e kuptonim rrezikun e veprave, përvojave dhe veprimeve tona, as rrezikun e fjalëve që shqiptonim me gjuhën tonë. Ne i lëshonim frerët pa asnjë litar për të na mbajtur lidhur, madje me natyrën tonë dhe vetvetiu ecnim të lirë pa asgjë që të na pengonte, ngjiteshim lart në botën tonë si një zog në ajër që qëndron aty ku dëshiron mbi një degë të njomë e të cicërojë dhe sa herë i bëjnë krahët që të fluturojë, ai fluturon dhe ngjitet lart. Kur ishim fëmijë të

“...Kujtesa jonë është regjistri në të cilin kanë bërë shënimet e veta baballarët, nënat tona dhe familjet, në mesin e të cilave u rritëm dhe prej burimit të të cilave pimë...”

vegjël ne regjistronim gjithçka që na zinin sytë me kamerën e tyre të vogël, ose gjithçka që dëgjonin veshët tona si valë zëri melodike, ose gjithçka që preknin duart tona të njoma, ose çdo aromë nga llojet e ndryshme të parfumeve dhe aromave që ne nuhasnim, ose gjithçka drejt së cilës na çonin këmbët tona në etapa të ndryshme me nxitim, ose duke mbajtur kokat tona lart me trupin drejt.

Ne përballeshim me një furtunë skenash dhe me situata të vazhdueshme, dhe me një shirit pamjesh me të gjitha domethëniet, ngjyrat dhe format që ato përcillnin, e të gjitha këto ne i ruanim në kujtesë ashtu siç ishin. Ne nuk përdornim mjete pastrimi dhe skanimi, as nuk vendosnim solucione pastruese, madje e merrnim gjithë këtë lëndë në formë bruto pa asnjë përpunim apo ndryshim. Ne e gdhendnim atë në kujtesën tonë, ashtu siç gdhendet një gur, që i ngjan memorizimit tonë tradicional në mejtepet e Kuranit dhe në shkollat e lashta me metodat e përsëritjes dhe dëgjimit sipas mënyrës së vjetër, pa pasur asnjë renditje për atë që shkruanim dhe gdhendnim.

Ne ishim si enët depozituese dhe librat e shkruar, të cilët regjistronin çdo ngjarje, të gjitha ditët tona të njëpasnjëshme, qofshin të hidhura apo të gëzueshme, të gjitha reagimet tona dhe të të tjerëve, qofshin të dukshme apo të padukshme, madje edhe ato

reagime që krijoheshin brenda nesh në kohët e perëndimit të diellit dhe gjithëka ngjante në kohën kur vinte errësira, kur ulerim nën dritën e hënës, ose pranë qirinjve të ndezur, madje edhe ato reagime që ia zinin frymën dhe nuk kishin zë që të bërtisnin, të cilat zënë vetëm një vend të largët në kujtesë.

Jeta jonë ishte në hapat e parë dhe ende nuk i kishim kapur ato vite kur njeriu ndjen përgjegjësi dhe ngjitet lart në pozitën e marrjes së vendimeve. Për këtë arsye ne nuk mbanim përgjegjësinë e asaj që depozitonim në kujtesën tonë, ashtu siç nuk mbanim përgjegjësinë e zgjedhjes së natyrës së rritjes sonë, as kushtet e jetesës sonë, as mënyrën e edukimit tonë, as traditat dhe zakonet me të cilat u mësua. Përgjegjësia e vërtetë binte mbi shpatullat e familjarëve tanë, mbi baballarët dhe nënat tona, mbi kujdestarin brenda familjes, mbi të gjithë ata që kishin vendimmarrjen në dorë, ata që kishin pushtetin e organizimit, mbi atë që udhëhiqte çështjet e shtëpisë dhe mbante shtyllat e saj, mbi bariun dhe kujdestaren brenda saj. Kujtesa jonë është regjistri në të cilin kanë bërë shënimet e veta baballarët, nënat tona dhe familjet, në mesin e të cilave u rritëm dhe prej burimit të të cilave pimë. Nga vrulli i përrenjve dhe lumenjve të këtyre familjeve fillon historia jonë, fillojnë ngjarjet e fëmijërisë sonë dhe kujtimet e të shkuarës sonë. Përkundrazi e gjithë shoqëria mban përgjegjësinë e kujdestarisë, ashtu siç mban edhe amanetin e ruajtjes së regjistrit të kujtesës sonë dhe amanetin e servisit të përmbajtjes së saj. Ne lindim dhe mbështillemi me një copë të bardhë, pimë qumësht të pastër, kemi trupa të njomë dhe koka bosh në të cilat renditen disa rafte me faqe të bardha dhe të kulluara, mbi të cilat asnjë laps nuk ka shënuar qoftë edhe një pikë bojë të zezë.

Ajo që ti mban sot në kujtesën tënde në

“Le të përjetësojmë për veten dhe për bijtë tanë një histori të mbushur me kontribut, një histori të lavdishme me të cilën të mburren brezat nesër, historinë tonë që meriton të jetojë dhe të shkruhet me bojë të artë dhe jo një histori të zymtë ...”

rini ose nesër në pleqëri, aty ku ti i shërben shoqërisë tënde nëpërmjet postit që ke, ose kur je në moshë të thyer me thinja që të kanë mbërthyer vizën e flokëve, me një kurriz të thyer dhe në vetmi, një pjesë e madhe e saj (kujtesës) ka mbledhur atë që është gdhendur në faqet e saj në vitet e para të jetës, një kujtesë e cila ka regjistruar disa njerëz që ti nuk i ke zgjedhur që të regjistrojnë në vendin tënd dhe as nuk ke kërkuar prej tyre që të ishin kapitenë për të udhëhequr anijen e kujtesës tënde me dëshirën e tyre dhe me zgjedhjen e tyre, apo që ta komandonin atë me forcën e pushtetit të tyre.

Fëmija që dje mbante një kujtesë të pastër dhe të kulluar, të pafajshme nga çdo gjynah, padrejtësi, e keqe apo lëndim sot është bërë i madh dhe brenda tij mban regjistrat e të shkuarës, ku do të ndjejë dhembjen që është rritur brenda tij, kur ishte i vogël dhe sot do ta përjetojë atë dhembje po me të njëjtën ndjesi, madje edhe më shumë, sepse ndjesia e tij është e pjekur

dhe e madhe. Në të njëjtën kohë ai do të ndjejë gëzimin e ngazëllimit dhe një buzëqeshje do të ndriçojë fytyrën e tij, ashtu siç e ndriçoi atë kur ishte i vogël. Gjithashtu ai do të ndjejë një kënaqësi të brendshme për harenë dhe mirësitë që përjeton shpirti i tij, që mburret me veshjet e tij të bardha, të cilat i ka veshur në momentet e lodrimit dhe dëfrimit të zbukuruara nga ditët e Bajramit.

Çdo kujdestar i një grupi individësh apo i një bashkësie e ka për detyrë që të kujdeset për shëndetin e kësaj kujtese, për ta mbrojtur nga çdo devijim, keqinformim, keqpërdorim dhe dëmtim, apo nga cenimi i të drejtave të saj dhe i paprekshmërisë së saj, sepse ajo kujtesë përbën regjistrin e brezave të ardhshëm, regjistrin e burrave dhe grave që nesër do të marrin në dorë poste ku merren vendime mbi të cilat do të ndërtohet një umet politikisht, nga ana arsimore, ekonomike etj.

Atëherë le të përgatisim, le të edukojmë dhe le të krijojmë një kujtesë të fortë dhe jo të mposhtur, një kujtesë të shëndoshë dhe larg defekteve, të metave dhe lodhjeve shpirtërore, le ta mbrojmë nga rrënimi dhe humbja, në mënyrë që të ruajmë mendjen dhe diapazonet e bijve të këtij umeti. Këto mendje do të jenë ato që do të krijojnë ide dhe me ndihmën e këtyre mendjeve do t'i vënë ato në zbatim në hapësira të gjera, me talentin dhe me vullnetin e tyre do të ndërtojnë fabrika, institucione dhe me to ndërtohen fondacionet... me ndihmën e të cilave vihet në lëvizje kultura e umetit, ngrihet civilizimi i tij, vendosen themelet dhe shtyllat e përparimit të tij dhe të suksesit të tij në të gjitha fushat e zhvillimit.

Le të përjetësojmë për veten dhe për bijtë tanë një histori të mbushur me kontribut, një histori të lavdishme me të cilën të mburren brezat nesër, historinë tonë që meriton të jetojë dhe të shkruhet

me bojë të artë dhe jo një histori të zymtë në librat e errësirës, të shkruar nga pena me bojë të bërë prej lotësh, që tregohet nga gjuha e mjerimeve dhe mësimëve të hidhura, nga rënkimi i zemrës dhe dhembja e saj. Nuk dëshirojmë nga bijtë tanë, që të qëndrojnë nesër para nesh dhe të na kërkojnë llogari për neglizhencën tonë karshi të drejtave të tyre dhe se ishim themeli i rrënimit për kujtesën e tyre dhe për prishjen e historisë së tyre.

Që të gjithë së bashku në këtë moshë madhore që jemi, le të shkruajmë në kujtesën e brezave historinë tonë dhe historinë e tyre, le të themelojmë për të ardhmen gjithçka që gëzon shpirtin, i cili mund të shprehet për këto mirësi me të gjithë lirinë e tij të ligjshme. Le të prodhojmë në kujtesën e tyre një jetë të lumtur, disa kujtime të bukura dhe imazhe të mrekullueshme, disa skena të rralla dhe ditarë madhështorë, në mënyrë që ata të mos i kaplojë frika gjatë etapave të jetës së tyre, apo që dëshpërimi të pushtojë faqet e kujtesës së tyre dhe si rrjedhojë të ndiqen prej dështimit kur të bëhen të mëdhenj dhe në sytë e tyre të zvogëlohen ambiciet, të humbasë forca brenda tyre, guximi të heshtë në gjuhët e tyre dhe shpirti të mbajë mbyllur ulërimën e tyre. Kujtimet tona kanë gjëra të shumta që meritojnë prej nesh që t'i kthehemi dhe t'i ndryshojmë kur jemi të mëdhenj, për aq kohë sa ishim të pafuqishëm në vegjëlinë tonë, që të krijojmë vetë regjistrin e saj dhe në këtë mënyrë të arrijmë të përjetësojmë për veten dhe për të gjithë ata që vijnë pas nesh gjithçka që mund të krijojë lavdinë e umetit. ■

Nga arabishtja: Genc Plumbi

GRUAJA E MENÇUR E PËRFITON BURRIN EDHE NËSE AI E URREN



Merr përsipër çdoherë përgjegjësi, pa marrë parasysh a ndodh ndonjë problem apo jo, madje edhe kur të ndodhi problemi zgjidhe çdoherë atë në formën më të butë dhe më të mirë të mundshme, pra me urtësi, që burri yt të ndjejë se ti je shpëtimtarja e tij në situata të tensionuara. Me këtë gjest ai arrin të kuptojë, se nuk mund të ndër marrë diçka pa ndihmën tënde

SHIRIN EL ULFIJ

Nuk do të thotë asgjë, se mungesa e dashurisë së burrit ndaj gruas së tij nuk e krijon mundësinë për një dialog mirëkuptimi dhe lindjen e një dashurie të re nga fillimi. Gruaja inteligjente di ta shfrytëzojë rastin, që pikëllimin e saj ta shndërrojë në ujitjen e pemës së dashurisë

në mënyrë të shkëlqyeshme, kështu që nuk i dorëzohet heshtjes dhe rastësisë së kohës dhe nuk lejon që pikëllimi t'i hajë zemrën e saj, mirëpo prapë qëndron pyetja:

Si ta përfitoj zemrën e burrit tim?

Pikësëpari bëhu e kënaqur me fatin tënd dhe qëndro falënderuese ndaj

**“Mos e anashkalo pamjen
tënde, pra kujdesu për bukur-
inë tënde se si dukesh, që ai
të ndjejë se ti je e bukur
vetëm për shkak të tij, ndërsa
kur të dalësh jashtë kujdesu
mirë për hixhabin dhe nikabin
tënd...”**

Dashuria

Bëhu optimiste përherë me ndjenjat e burrit tënd, bëje atë të ndjejë nevojë dhe dëshirë për ty, po ashtu këtë gjë bëje që ai të reagojë ndaj teje me dashuri, formo me të një gjuhë të përbashkët në shikim, i cili jep sinjale mirëkuptimi, kur ai të mos jetë afër teje ti atëherë lësho shi mbi të me letra dashurie, kështu që të formosh bindjen tek ai se ti vuan në pritje të tij, sepse dashuria sjell sinqeritet, prandaj qëndro çdoherë e sinqertë ndaj tij. Mos tradheto asnjëherë në jetën tënde bashkëshortore, ji besnike ndaj pasurisë së tij, kjo e bën atë që të besojë te ti, respektoje atë me urtësi e jo verbërisht. Po ashtu po të tregoj se dashuria dhe sinqeriteti sjellin dhuratë, për këtë arsye mundohu që burri yt ta shijojë fisnikërinë tënde dhe se ti në çdo çast nuk je koprrac me të, qoftë ajo me kohën tënde, ose me përpjekjen tënde, ose me pasurinë tënde për të. Kjo i jep atij të kuptojë, se ti sakrifikon çdo gjë për të, kjo po ashtu i dhuron atij besim ndaj teje, kështu që

Allahut, sepse kënaqësia me atë që ke është çelësi i lumturisë së dynjasë dhe ahiretit... po ashtu dije se Allahu të ka sprovuar me të, vallë a do ta falënderosh Allahun për caktimin e tij ndaj teje apo jo? Po ashtu mos harro, se ti shpërblehesh për durimin tënd me lejen e Allahut, sepse sprova jote që po jeton me një burrë, i cili nuk të do, pas kësaj mund të fshihen mirësi të ndryshme, të cilat ti ndoshta nuk i di. ***“Ndoshta ju urreni diçka e ajo është e mirë për ju.”*** (Bekare:216)

kundërpërgjigjja e tij ndaj teje është: Të dhuron çfarë t'i kërkesat.

Shpirti yt

Bëhu e drejtë dhe e besueshme me shpirt për të, bëhu shoqja e tij, bisedo me të në lidhje me punën dhe shqetësimet e tij, këto metoda ruaji, diskuto me të dhe mësohu t'i lexosh kërkesat e tij. Po ashtu mos e anashkalo pamjen tënde, pra kujdesu për bukurinë tënde se si dukesh, që ai të ndjejë se ti je e bukur vetëm për shkak të tij, ndërsa kur të dalësh jashtë kujdesu mirë për hixhabin dhe nikabin tënd... Mos e bëj atë tërheqës, joshës, sfidues, pra le të të shohë vetëm bashkëshorti yt në formën më të bukur që dëshiron ai dhe kur të dojë ai.

Ti je dikush

Merr përsipër çdoherë përgjegjësi, pa marrë parasysh a ndodh ndonjë problem apo jo, madje edhe kur të ndodhi problemi zgjidhe çdoherë atë në formën më të butë dhe më të mirë të mundshme, pra me urtësi, që burri yt të ndjejë se ti je shpëtimtarja e tij në situata të tensionuara. Me këtë gjest ai arrin të kuptojë, se nuk mund të ndër marrë diçka pa ndihmën tënde. Edhe pse burri dëshiron që gruaja të marrë përgjegjësi kur te këtë nevojë ai për to, mirëpo prapë se prapë ti përpiku që ai të ketë nevojë për ty, siç ka nevojë ai për banim, pra ti bëhu vendbanimi i tij. Mos kurse që ta ushqesh atë me strehim, bëhu nënë për të, dashuroje atë ashtu siç i do nëna fëmijët e vet, mundohu që ai ta kuptojë se ti me të

“...Mos flit çdoherë, e as e heshtur çdoherë, mos u bëj dëgjuese çdoherë, e as ajo që flet çdoherë, mos rri e zbukuruar çdoherë, e as mos e lër pas dore zbukurimin shpesh...”

vërtetë e do atë, se ti je e pasionuar ndaj tij dhe se nuk duron dot që atë ta kaplojë ndonjë fatkeqësi. Qëndro me të në çdo problem qoftë ai material apo shpirtëror. Kjo do ta bënte atë që të drejtohet kah ti dhe vetëm kah ti në çdo kohë dhe vështirësi.

Xheneti yt

“Burri yt është xheneti i kësaj bote”. Shijo sikur ai është gjëja më e rëndësishme për ty në këtë botë, po ashtu mos e ndjej asnjëherë se ndonjë njeri është më i vlefshëm për ty më shumë se burri yt, qoftë ai edhe djali apo babai yt. Kjo nuk do të thotë që ti të mos i respektosh prindërit e tu, mirëpo mos fut dikë në llogarinë e tij. Po ashtu duhet të arrish të kuptosh rëndësinë e tij në jetën tënde, çdoherë falënderojë atë për çdo gjë që ta ofron qoftë ajo edhe diçka e thjeshtë.

Pavarësia

Në të njëjtën kohë bëhu e pavarur, ki çdoherë qëndrimet e tua, personalitetin tënd të posaçëm, shpëtimin tënd specifik,

kjo e bën atë që të të vlerësojë. Bëhu modeste çdoherë, mos flit çdoherë, e as e heshtur çdoherë, mos u bëj dëgjuese çdoherë, e as ajo që flet çdoherë, mos rri e zbukuruar çdoherë, e as mos e lër pas dore zbukurimin shpesh, ki kujdes mos të jesh dembele në gjëra që për të kanë rëndësi meqë shumica e burrave duan që gratë e tyre t'i shohin të natyrave të ndryshme, që ndryshojnë kohë pas kohe në çështje të ndryshme, e jo të natyrës së njëjtë. Prandaj burri nuk dëshiron të dëgjoj vazhdimisht fjalën: Ja ku jam, sepse një gjë të tillë e kërkon nga gruaja vetëm ai që nuk i zë besë gruas s vet.

10 gjëra që ia shkatërrojnë zemrën atij!

Dije se në qoftë se je e kundërta e asaj çfarë cekëm kjo mund të çojë që t'ia shkatërrosh zemrën burrit tënd, sepse një grua e cila nuk di se çfarë do nga burri i saj nxiton ta humbë atë, prandaj këshillat e mia për atë që shpejton të largohet nga burri i saj janë këto, pra, kujdes nga dukuritë negative si:

1. **Idiotizmi:** Mos mendo, sepse truri yt është i krijuar të mos lodhet, jepi atij një pushim.

2. **Gënjeshtria:** Gënjeje atë dhe fshih prej tij çdo gjë, bëje atë që të mos zëri besë asnjëherë.

3. **Lodhja:** Mos ndrysho nga vetja diçka, përqendrohu në çdo gjë që e ngushton burrin tënd.

4. **Injoranca:** Harro çdo lëvdatë që ke arritur ndaj tij dhe të tij, duke ndjekur çdoherë programet televizive për përgatitjen e ushqimeve dhe ato të filmave serik.

5. **Harresa:** Mos i kushto rëndësi burrit tënd mirëpo jepi përparësi më të madhe fëmijëve të tu dhe prindërve të tij.

6. **Ftohtësia:** Gjatë marrëdhënieve me të ofroi atij ndjenjën, se ti je si druri dhe mos i ofro atij harmoni dhe ngrohtësi asnjëherë (turp!... mos u bëj motor që punon për të!).

7. **Inati:** Mos e dëgjo, polemizo me të çdoherë, mos i zbato urdhrat e tij kurrë.

8. **Pamja:** Mos u shfaq para tij në shtëpi e bukur kurrë, sepse ai të ka martuar (s'ka nevojë përse), ha sa më shumë derisa të bëhesh si fuçi!

9. **Mos respektimi:** Poshtëroje çdoherë para familjes dhe fëmijëve të tij.

10. **Koprracia:** Koprraci në ndjenja, si dhe koprraci në pasuri, kur ta shohësh burrin tënd në hall dhe ka nevojë për ndihmë materiale ose shpirtërore mos i jep rëndësi fare.

Dhe përfundimisht urime për divorcin e sigurt, sepse njëra prej tyre mjafton për të ardhur deri në divorc, e lëre më disa prej tyre! I përmenda këto cilësi të këqija të një gruaje, të cilat kanë si përfundim ndarjen apo përfundimin e martesës, ngaqë shumë nga gratë i përdorin këto gjëra dhe pastaj habiten, se pse burri i saj nuk e do më atë dhe rri larg saj. Prandaj gruaja inteligjente e do burrin e saj me sinjeritet, e nuk shtiret në dashurinë e saj, sepse burri i mençur e dallon dashurinë e vërtetë-reale e kur e kupton një gjë të tillë, ajo më vonë apo më herët do të reflektohet në sjelljen e tij ndaj saj. ■

Shqipëroi: Nexhat Ceka

GRUAJA MUSLIMANE DHE PËRGJEGJËS ITË E DAVES (2/2)

Femra thirrëse e suksesshme shpesh praktikon vetë-llogaritjen dhe njeh të metat e saj. Ajo kritikon metodologjinë e saj në Dave, ku në mënyrë konstruktive duhet të njohë pikat e saj të dobëta për t'i korrigjuar ato dhe përparësitë e të mirat e saj, në mënyrë që t'i rrisë dhe t'i zhvillojë ato.

islamweb.net

Bindja në Sheriat pa devijim

Qëndrimi ndaj mësimit të Islamit pa devijime apo ndërrime është njëri nga themelet të cilat një grua thirrëse duhet ta ketë parasysh kur bën Dave, sepse gjithë e mira qëndron në Sheriatin e Allahut të Plotfuqishëm dhe rrugën e Tij. Shejh Muhamed ibën Abdullah Duvejsi, thotë:

“Veprat e qenieve njerëzore asnjëherë nuk do të konsiderohen të qëlluara, pa marrë parasysh sa të larta janë pozitat e tyre, statusi dhe gradat e drejtësisë dhe të devocionit. Ato duhet të krahasohen me udhëzimin e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Nëse flasim për durimin na është përcjellë, se një burrë i vjetër një herë kishte vallëzuar mbi varrin e djalit të tij, kur i vdiq ai, për të treguar përmbajtjen me Urdhrin e Allahut të Plotfuqishëm, ashtu siç kishte deklaruar ai. Sidoqoftë udhëzimi i Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është më i mirë se i këtij njeriu. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, derdhi lot dhe zemra e tij u pikëllua, por ai nuk nxori asnjë fjalë përveç asaj që ishte i kënaqur Zoti. Gjithashtu udhëzimi gojor dhe praktik i Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në fjetje dhe lutje natën është më i mirë, se sa ajo çka është transmetuar për ata të cilët e kryenin namazin e sabahut me abdesin e Jacisë për shumë vite. Udhëzimi i tij në këndimin e Kuranit është gjithashtu më i mirë se çka është transmetuar për ata të cilët e këndonin Kuranin brenda natës. Megjithatë, ne nuk kërkojmë arsyetim për ata të cilët e bënë këtë në varësi të ixhtihadit të tyre prej paraardhësve të tyre të drejtë.

Metoda dhe sugjerime për Daven

Më parë konstatuam bazat e Daves. Për sa i përket problemeve me të cilat thirrësi ballafaqohet në rrugën e tyre, Shejh Muhamed ibën Abdullah Duvejshi, ish-anëtar i stafit të Universitetit Imam Muhamed ibën Saud, thotë se janë probleme të trashëguara nga metodat e kufizuara dhe mungesa e kreativitetit. Ky model në mënyrë të qartë paraqitet në thirrjen grua-gruas, madje edhe në aktivitetet që meshkujt ua paraqesin grave. Kur një

“...Femra thirrëse duhet të rrisë besimin e saj duke u munduar të jetë sa më afër Allahut të Plotfuqishëm përmes agjërimit, namazit të natës, këndimit të Kuranit, bamirësisë dhe veprave të tjera të adhurimit...”

thirrës mashkull flet para grave ai shpesh ka të bëjë me tema të kufizuara, të cilat nuk mund t'i kalojë, dhe e njëjta gjë ndodh edhe me thirrësen femër. Të dy thirrësit, meshkuj dhe femra janë në nevoja të mëdha për një ndryshim dhe zhvillim në mënyrën e adresimit të tyre të Daves. Disa nga metodat e përshtatshme që një thirrëse femër mund të përvetësojë janë:

Përpjekja për të ndikuar te miqtë e saj në shkollë, fqinjët dhe të afërmit me fjalë të mira dhe me moral të mirë.

Krijimin e programeve të përbashkëta në mes grupe miqsh, të tilla si mbajtja e ligjëratave, ku lexohen libra që kanë të bëjnë me bazat e Islamit, si mësim-besimi Islam dhe rregullat e namazit.

Përgatitja e kuizeve edukative dhe kryerja e tyre në mesin e studentëve, të afërmeve dhe fqinjëve.

Fleta të shkruara me këshilla dhe porosi udhëzuese, që ndërliken me vajzat e shkujdesura për t'i udhëzuar ato, dhe vajzave të mira, për t'u bërë thirrje atyre që të vazhdojnë t'i përmbushin detyrimet e tyre.

Bashkëveprimi dhe pjesëmarrja në faqet e internetit dhe programet transmetuese të posaçme, që kanë të bëjnë me gratë. Një gjë

që mund të bëhet është t'i njoftojë ato dhe të shpërndaje adresat në mesin e të rejave. Këto janë vetëm sugjerime dhe natyrisht nuk përfshin gjithçka që mund të bëhet.

Shejh Muhamed Duvejshi siguron se është e nevojshme të përdoret elementi narrativ në bërjen e Daves, për këtë shërben një nga metodat e Kuranit. Kështu, Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte i kujdesshëm ta bëjë këtë për shkak të ndikimit të tij të madh te njerëzit. Librat e Sunetit kanë ruajtur për neve një seri tregimesh dhe thëniesh të Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që kanë të bëjnë me popujt e kaluar. Tregimet nga Kurani dhe Suneti nuk janë vetëm tregime dhe ngjarje e njerëzve të mirë; por ato përfshijnë edhe tregime të njerëzve të pamoralshëm dhe të atyre që devijuan nga rruga e drejtë, kështu që ne mund të marrim mësim nga ajo që i ka goditur ata. Megjithatë ky element duhet të përdoret racionalisht. Kjo do të thotë se nuk duhet të jetë e vetmja metodë e përdorur në kurriz të faktorëve të tjerë. Veç kësaj është e nevojshme të rrëfihen vetëm tregime autentike.

Çështje të rëndësishme për femrën thirrëse në Islam

Temën tonë do ta lidhim duke përmendur disa pika që thirrësja femër duhet të ketë në konsideratë, në mënyrë që të ketë një efekt të vërtetë në fushën e Daves, dhe pastaj do t'i përmendim disa cilësi të thirrëses së suksesshme. Së pari, femra thirrëse duhet të rrisë besimin e saj duke u munduar të jetë sa më afër Allahut të Plotfuqishëm përmes agjërimit, namazit të natës, këndimit të Kuranit, bamirësisë dhe veprave të tjera të adhurimit. Kjo do ta ndihmonte atë t'i thërrasë të tjerët në Allahun Fuqiplotë dhe të shpresojë për shpërblimin e Tij. Së dyti, është e nevojshme

“Ajo nuk duhet të lejojë që puna e saj në fushën e Daves të jetë arsye për shkujdesje ndaj shtëpisë dhe fëmijëve të saj...”

për të, që të lexojë disa libra edukativë së bashku me libra të diturive fetare. Kjo do ta ndihmonte atë, që me vendosmëri dhe në mënyrë të qartë të bëjë Dave me urtësi dhe qëndrueshmëri në paraqitje dhe të shkruar. Gjëja e tretë është se ajo nuk duhet të lejë pas dore fëmijët e saj dhe duhet të përqendrohet në edukimin dhe rritjen e tyre, që një ditë ata të jenë model për njerëzit e tjerë. Ajo nuk duhet të lejojë që puna e saj në fushën e Daves të jetë arsye për shkujdesje ndaj shtëpisë dhe fëmijëve të saj. Gjëja e katërt është se ajo duhet të ofrojë dhe t'i japë ndihmë kujtdo që është në gjendje t'i ndihmojë, dhe të mundohet të qëndrojë me të afërmit në kohë krize. Ajo duhet t'i mbështesë ata, sepse kjo i bën ta duan atë, dhe si pasojë këshillat e saj i bëjnë ata të gjithë më shumë efektiv.

Cilësitë e thirrëses së suksesshme

Duhet të nënvizohet se femra thirrëse ka cilësi dhe merita të caktuara, dhe gruaja muslimane duhet t'i dijë këto kualitete, t'i përvetësojë ato dhe të qëndrojë pas tyre. Ajo është një grua, e cila e pranon ndihmën e Allahut në aspektin e udhëzimit dhe të suksesit. Për këtë arsye ajo është gjithmonë modeste dhe e përlur, gjithsesi ajo e ruan dinjitetin dhe nderin e saj. Njohja e të mirave të Allahut mbi të. Ajo asnjëherë nuk e përbuz asnjë grua, që nuk bindet ose nuk i përmbahet hixhabit. Në vend të kësaj ajo

shpreson për udhëzim dhe sukses, dhe mendon pakujdesinë dhe nevojën e ndryshimit të vetes së saj. Ajo gjithmonë përsërit lutjet në vijim, “Allahumme mukal-libel kulub thebbit kalbi ‘ala dinik. (O Allah! Rrotullues i zemrave! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde).” Femra thirrëse e suksesshme është ajo që mban një ekuilibër në mes shtëpisë së saj, burrit, fëmijëve dhe punës së saj në fushën e Daves. Ajo e di se të bësh Dave nuk bie ndesh apo nuk përplasat me ndonjë nga detyrat e saj. Kjo është një çështje organizimi, menaxhimi dhe shfrytëzimi i mundësive dhe kohës për të bërë gjëra të dobishme.

Femra thirrëse e suksesshme gjithashtu vazhdon inkurajimi e atyre që Allahu i Plotfuqishëm i udhëzon në dorën e saj, duke i motivuar ato për të bërë Dave dhe duke i inxitur ato për të përparuar në atë rrugë. Ajo i shikon kushtet e tyre që ato mos të dorëzohen gradualisht nga puna e tyre dhe të devijojnë. Gjithashtu, femra thirrëse e suksesshme, nuk është e kënaqur me një këshillim të thjeshtë dhe me përkujtimin e njerëzve, por ajo gjithashtu mundohet për të bërë pozitën e saj shoqërore, punën dhe veprat e saj pranverë sipas Sheriatit të Allahut Fuqiplotë. Ajo është thirrëse me fjalët, qetësinë e saj, pjesëmarrjen dhe mungesën e saj. Veprat e saj përputhen me fjalët e saj.

Femra thirrëse e suksesshme është ajo që përpiqet të dalë me metoda të reja të pranuar nga Sheriati dhe mënyra të mençura për të thirrur të tjerët, ashtu që kreativiteti i saj në projektet e mirësisë të jetë në dobi të njerëzve dhe t’u tregojnë atyre rrugën e drejtë. Femra thirrëse e suksesshme është ajo e cila kapacitetet e saj i kushton për të shërbyer në këtë fe, qoftë ajo të jetë përmes dhënies së mësimave, ligjëratave, kuizeve ose të shkruarit nëpër gazeta dhe revista, ose aktivitete të tjera, të

“Femra thirrëse e suksesshme është ajo që përpiqet të dalë me metoda të reja të pranuar nga Sheriati dhe mënyra të mençura për të thirrur të tjerët...”

cilat përkojnë me Sheriatin fisnik. Femra thirrëse e suksesshme shpesh praktikon vetë-llogaritjen dhe njeh të metat e saj. Ajo kritikon metodologjinë e saj në Dave, ku në mënyrë konstruktive duhet të njohë pikat e saj të dobëta për t’i korrigjuar ato dhe përparësitë e të mirat e saj, në mënyrë që t’i rrisë dhe t’i zhvillojë ato. Në gjithë këto platforma ajo shpreson për shpërblimin e Allahut Fuqiplotë dhe nuk i kushton vëmendje vlerësimeve të njerëzve. Ajo kërkon shpërblimin e Allahut në vetmi. Femra thirrëse e suksesshme beson se gjakftohtësia është më e favorshme në të gjitha çështjet dhe punët e saj, në veshjen e saj, shtëpinë, ushqimin dhe çdo gjë tjetër në jetën e saj. Ajo nuk ka, as teprime, as koprraci në jetën e saj. Ajo vesh rroba që përshtaten me pozitën e saj si një thirrëse. Ajo i përmbahet hixhabit pa ekzagjerime dhe në të njëjtën kohë nuk shfaqet e leckosur apo e pakujdesshme. Kjo është vetëm një përmbledhje e shkurtër për disa çështje që kanë të bëjnë me gruan muslimane, e cila thërret drejt Allahut Fuqiplotë. A e realizojnë gratë tona vlerën e kësaj dhe i kushtojnë vëmendjen që meriton? ■

Nga anglishtja: Drita MALIQI



Allahu ka thënë: *“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.”*

SHKRUAN: ALI SHABANI

I Dërguari i Allahut Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* e kumtoi Islamin me besnikëri dhe qartësoi gjithçka, ai i tregoi të gjitha gjërat që të afrojnë për në xhenet dhe po ashtu i qartësoi të gjitha gjërat që largojnë nga xhehenemi. Mes tyre e bëri të qartë se

gjëja më madhështore dhe më e rëndësishme është teuhidi – njësimi i Allahut të Vetmit dhe e bëri të qartë se gjëja më e shëmtuar dhe më dëmprurëse është shirku – t’i përshkruash Allahut rival. Ai sakrifikoi shumë në këtë rrugë duke i thirrur njerëzit në shpëtim dhe lakmonte shpëtimin e tyre nga zjarri i xhehenemit, por megjithatë pati prej tyre që

nuk e besuan siç e ka përmendur Allahu i Gjithëdijshëm: ***“Po ti edhe pse lakmon (për besimin e tyre), shumica e njerëzve nuk do të besojnë.”*** Jusuf 103.

Për këtë përgjegjësi që i dha Allahu Pejgamberit të tij i premtoi shpërblim të madh në botën tjetër në Ahiret, dhe e porositi që mos të lakmojë në dynja dhe mos të kërkojë shpërblim nga njerëzit: ***“Megjithatë që ti nuk kërkon prej tyre ndonjë shpërblim për të (për këshillë e udhëzim).”*** Pastaj tha ***“Ai (Kurani) nuk është tjetër vetëm se këshillë për mbarë njerëzit.”*** Jusuf 104. Thirrja e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* ishte universale për të gjithë dhe po ashtu Kurani është Libër për udhëzim për të gjithë. Fton në besimin e Allahut Një, në teuhid, në pasimin e të Dërguarit të Tij, në moral dhe sjellje të mirë. Njerëzit kanë pasur dhe kanë fakte në natyrë dhe horizont, që i shohin në jetën e tyre të përditshme, megjithatë shumë prej tyre vazhdojnë të mos besojnë me besim të drejtë: ***“Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare.”*** Jusuf 105. A nuk e shohin qiellin, yjet natën që ndriçojnë, malet, lumenjtë, detet e oqeanet, erërat që fryjnë në drejtime të ndryshme, llojet e ushqimeve dhe shijet e tyre, racat e njerëzve dhe gjuhët e tyre dhe shumë fakte të tjera. A nuk meditojnë rreth këtyre gjërave e të ngrenë, pyetjen se kush është krijuesi i të gjithë këtyre krijesave? Mirëpo edhe pse duhet ta kenë besimin e pastër në Allahun e Madhëruar, ata e njollosin me besime të kota, me besëtytni: ***“Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun, përveçse duke i shoqëruar*** (zota të tjerë).” Jusuf 106.

Ebu Said ibën Ebi Nedaletë ka thënë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* duke thënë: ***“Kur t’i tubojë Allahu të parët dhe të fundit në ditën që s’ka dyshim, thërret një thirrës: “Kush i ka shoqëruar Allahut dikë tjetër (në veprat që***

“...Xhahilijeti paraislam vazhdon edhe sot, por ka përmasa më të mëdha sa që shumë nga ata që deklarohen vetëm me gojë se janë muslimanë lakmojnë dhe anojnë të arrijnë suksese me thirrjen e xhahilijetit modern ...”

bëhen për Allahun), *le të kërkojë shpërblimin prej dikujt tjetër përpos Allahut, se Allahu është larg asaj që ata i shoqërojnë.*” (Ahmedi). Këta njerëz me besim të shtrembër e të gabuar: ***“A mos janë siguruar ata prej dënimit që mund t’u vijë nga Allahu e t’i mbulojë, ose befas duke mos e hetuar fare t’u vijë katastrofa e përgjithshme.”*** Jusuf 107.

Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* e vazhdoi misionin e tij me zell, pa marrë parasysh se kush e përqafoi udhëzimin e tij apo i shmanget. Allahu i Lartësuar i pat thënë atij: ***“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.”*** Jusuf 108. D.m.th. se Allahu i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Tij që këtë ta shpallë para të tjerëve, besuan apo nuk besuan, e njësuat Allahun, apo i bënë shirk, u udhëzuan, apo devijuan ***“Kjo është rruga ime,...”*** thirrje në dëshminë se nuk ka Zot tjetër që duhet të adhurohet, përpos Allahut të Vetmit të pashoq. Është thirrje: ***“e vënë në fakte të qarta”*** me argumente bindëse logjike dhe sheriatike, ku nuk vjen në shprehje dyshimi. Këtë thirrje Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* e ka bërë së bashku me sahabët dhe të

gjithë ata që vijnë pas dhe e ndjekin atë, thërrasin në të njëjtën rrugë: ***“e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje...”*** thërrasim në besim të pastër dhe themi ashtu siç i ka thënë Allahu i Madhëruar Pejgamberit të Tij të thotë: ***“subhanallah - Larg të metave është Allahu e unë nuk jam nga idhujtarët”***. Kjo do të thotë se thirrësit në këtë rrugë duhet ta shprehin haptazi këtë, ta shpallin haptazi këtë thirrje dhe t’ua drejtojnë të tjerëve në përgjithësi. Të bashkohen me ata që e kanë besimin njësoj me ta dhe të distancohen nga ata që nuk e kanë besimin njësoj dhe që nuk ndjekin rrugën që ndjekin ata. Rruga e drejtë, rruga e Pejgamberit të Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* është rrugë e pastër nga xhahilijeti, nga jeta pagane paraislame, e pastër nga idhujtaria, e pastër nga imoraliteti, e pastër nga mashtrimet dhe manipulimet, e pastër nga diskriminimi. Thirrësit në këtë rrugë duhet të dallohen domosdoshmërisht në shoqëri me virtyte brenda kornizës së Islamit prej të tjerëve, prej shoqërisë injorante. Xhahilijeti paraislam vazhdon edhe sot, por ka përmasa më të mëdha sa që shumë nga ata që deklarohen vetëm me gojë se janë muslimanë lakmojnë dhe anojnë të arrijnë suksese me thirrjen e xhahilijetit modern të shekullit XXI nëpër kanale të ndotura me shirk, imoralitet, padrejtësi dhe shumë zullume të tjera. Kjo padyshim nuk është ajo në të cilën ka thirrur Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ai ka thirrur me të njëjtën thirrje si pejgamberët e mëparshëm: ***“Ne nuk dërguam para teje përveçse burra nga banuesit e qyteteve, të cilët i pajisëm me shpallje...”***. Ata që besuan, shpëtuan nga dënimi i Allahut, e ata që ia kthyen shpinën kësaj thirrje dështuan dhe i kaploi dënimi i Allahut dhe sot vendbanimet e tyre janë shndërruar në gërmadha: ***“...A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shihnin se si ishte përfundimi i atyre që ishin më parë?”***. Nga kjo

duhet të marrim mësim të gjithë. Ne duhet ta falënderojmë Allahun, që na ka bërë prej besimtarëve dhe që thërrasim në rrugën e drejtë, ashtu siç ka thirrur i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem*, e të tjerët të marrin mësim e të mendojnë për udhëzimin e tyre dhe mos të vazhdojnë devijimin e tyre. Allahu i Madhëruar në vazhdim thekson se prioritet ka Bota tjetër me begatitë që i presin të devotshmit: ***“E s’ka dyshim se jeta e botës së ardhshme është shumë më e dobishme për ata të cilët janë ruajtur; a nuk mendojnë?”***

Disa e kanë humbur shpresën se me anë të Islamit mund t’i ndihmojnë të tjerët, meqë nuk kanë pushtet, dhe pushtetin e mbajnë parti të ndryshme demokratike. Ata “thirrës islam” përpiqen që nëpërmjet një fushe të huaj të arrijnë fitoren, fushë që as vetë nuk janë kompetentë dhe nuk përputhet thirrja e tyre me atë të rrymave dhe politikave të sistemit demokratik (që më tepër përputhet me xhahilijetin paraislam). Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“(nuk dërguam tjetër përveçse burra e ndihma u vonua) Derisa të dërguarit gati e humbnin shpresën*** (se do t’i besojë populli), ***dhe menduan se u përgënjeshtroan*** (pse ende nuk i kapi dënimi), ***atëherë u erdhi atyre*** (të dërguarve) ***ndihma Jonë. Ne e shpëtuan atë që deshëm. E dënimi Ynë kundër popullit idhujtar nuk zmbropset.***” Jusuf 110. Këtë Ajet duhet ta lexojë thirrësi i sotëm përditë që ta ketë ndihmës dhe këshillë, që mos të mendojë ndonjëherë e të lakmojë nëpërmjet rrugëve të tjera të mundohet për të bërë mirë. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Thuaj: “A t’ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre? Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë duke bërë mirë.”*** Kehf 103, 104. E lusim Allahun e Madhëruar me emrat e Tij më të bukur dhe cilësitë e Tija më të larta, që të na udhëzojë neve në rrugë të drejtë. Amin ■



PASHA ALLAHUN, KJO FE DO TË PËRHAPET

Habab ibën Ereti, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon se një ditë shkoi tek i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili po qëndronte i ulur mbi pallton e tij nën hijen e Qabesë dhe filloi t'i ankohej për gjendjen e mjeruar, duke iu lutur me fjalët: Sikur të kishe kërkuar ndihmë për ne, sikur të ishe lutur! Atëherë i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “Në kohë të tjera para jush merrej njeriu (besimtari) dhe pasi hapnin një gropë në tokë e futnin në të e pastaj e ndanin për gjysmë me sharrë, duke filluar ta presin nga koka. Gjithashtu krihej me krehër hekuri, i cili ia ndante mishin (dhe muskujt) nga kockat, megjithatë asgjë nga këto mundime nuk e largonin nga feja e tij. Pasha Allahun do të plotësohet (përhapet) kjo fe aq shumë deri sa do të ecë udhëtari prej Sanasë deri në Hadrameut, duke mos iu frikësuar askujt, pos Allahut dhe ujkut se mos i han delet, mirëpo ju jeni popull që po nguteni”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Buhariu vetëm në hadithin nr. 3852, si dhe tek Ebu Davudi.

Ky hadith është i saktë. Atë e shënon imam Buhariu në “Sahihun” e tij nr. 3612, 3852, 6943, dhe Ebu Davudi në “Sunen”, nr. 2649. Pjesa e hadithit e futur në kllapa (dhe muskujt) përmendet tek

Shkaku i hadithit.

Përmendet në transmetimet e sakta, se Hababi, *radijallahu anhu*, ishte rob tek një grua kurejshite që quhej Umu Enmar. Ai

punonte shpatë-ndreqës dhe pasi dëgjoi për thirrjen e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e pranoi Islamin, mirëpo mushrikët e munduan aq shumë sa me lejen e pronares së tij filluan edhe t'ia digjnin trupin me hekur të skuqur derisa i shuhej nxehtësia e hekurit në dhjamen e trupit të tij. Kështu një ditë ai shkoi tek Profeti dhe i bëri këtë lutje.

Komenti i hadithit:

Hadithi tregon për kohën kur muslimanët ishin të dobët në Mekë dhe kërkuan nga Profeti të lutej për ndihmë. Ai filloi t'i inkurajonte duke u treguar atyre shembuj të keqtrajttimeve të besimtarëve para kohës së Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ju tregoi shembuj të keqtrajttimeve maksimale, ku më pas nuk kishte më vështirë dhe nuk kishte shpëtim. Gjithashtu nëpër disa hadithe të tjera ai përmend se jobesimtarët nuk i kursenin as profetët e tyre nga keqtrajtimet dhe vrasja, prandaj besimtarët duke i mësuar këto shembuj kuptojnë se nuk janë të vetmit që po ju ndodhin gjëra të tilla, përkundrazi ka pasur edhe besimtarë të tjerë, madje edhe profetë, të cilët tek Allahu padyshim ishin më të mirë se sa ju dhe prapë Allahu për urtësi të caktuara e lejoi që të vdisnin dhe të keqtrajtoheshin nga duart e qafirëve.

Fjala: sikur të kishe kërkuar ndihmë për ne, sikur të ishe lutur!

Me këtë Hababi nënkupton se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, mund të lutej dhe atij Allahu do t'ia pranonte lutjet, megjithatë ai nuk u lut dhe përgjigja e tij u fokusua në dy aspekte: i pari: duke u treguar për popujt përpara nesh dhe

“...Në fund të hadithit u dha mësimin dhe mënyrën se si arrihet deri tek fitorja, pra me mos-ngutje, me sabër dhe duke ndjekur radhën e gjërave apo rregullave që janë të vendosura nga Allahu në fytyrë të tokës...”

vuajtjet e tyre dhe për të ardhmen e muslimanëve, nëse i përmbahen një kushti: e ai kusht kuptohej përmes fjalës: **“mirëpo ju jeni popull që po nguteni”**.

Me këtë fjalë në fund të hadithit u dha mësimin dhe mënyrën se si arrihet deri tek fitorja, pra me mos-ngutje, me sabër dhe duke ndjekur radhën e gjërave apo rregullave që janë të vendosura nga Allahu në fytyrë të tokës.

Nëse ndalemi dhe pyesim veten: A thua pse Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk u lut për ndihmë të përgjithshme, që t'i shfaroste Allahu të gjithë qafirët dhe kështu të merrte fund çdo brengë e muslimanëve?

Shkakun do ta kuptonim përmes këtyre pikave:

- I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte njeri i inspiruar, ishte largpamës dhe dëshironte t'i edukonte shokët e tij dhe besimtarët, se fitorja nuk arrihet vetëm duke qëndruar duarkryq dhe duke pritur që ajo të zbresë nga qielli, nuk duhet të bëhemi parazitë e duke pritur vetëm nga lutjet dhe fitorja të vijë prej qielli.

- Besimtarët duhet të punojnë, të mos ndalen së vrapuari lart e poshtë dhe duhet t'i arrijnë shkaqet e fitores. Pra, kursesi nuk duhet të tregohen pasivë, të pakujdesshëm dhe neglizhues.

-Ai duke mos u lutur për fitoren e gatshme gjeneratave të tjera që do të vinin më pas nuk iu lente shkas të ankoheshin, se në kohën profetike ishte më lehtë pasi me një lutje ata fituan kundër armiqve të tyre, ndërsa në kohët tona është vështirë, sepse nuk ka Profet në kohën tonë të lutet për ne që të fitojmë e kështu do të humbnin çdo shpresë besimtarët.

-U dha një mësim gjeneratave të mëvonshme, se fitorja kërkon sakrifica, e duke sakrifikuar sahabët bashkë me Profetin do të thotë automatikisht, se edhe gjeneratat pas tyre ishte e arsyeshme që të mundohen nga armiqet e kështu askush të mos ketë kritika apo zili ndaj tjetrit.

Shkaqet dhe urtësia e vonesës së fitores:

Padyshim se çdo gjë që ndodh në fytyrë të tokës ajo ndodh me urdhrin dhe lejen e Allahut, prandaj edhe vonesa e fitores i ka shkaqet e veta, por nuk mungojnë as edhe urtësitë. Duke mos pasur si qëllim përmbledhjen e të gjitha urtësive unë do të veçoja disa prej tyre, si në vijim:

1. Kundërshtimet e mëdha mes vete, sidomos ato në çështjet e fesë, ku secili pretendon se rruga e tij është e qëlluara e të tjerët janë në gabim, por e vetmja rrugë e vërtetë është Kurani dhe udhëzimi i Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe kuptimi i këtyre dy burimeve sipas kuptimit të tri gjeneratave të para. Allahu thotë: ***“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit***

“...Ndodh të vonohet ndihma, për arsye se muslimanët ka raste kur luftojnë për synime jo të drejta, apo për qëllime të përfitimeve ose dëshirave të kësaj bote...”

të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia.” (Enfal, 46)

2. Vonohet që umeti islam të japë apo të shpenzojë për arritjen e saj çdo gjë të shtrenjtë që ai zotëron, duke iu bërë kështu gjëja më e shtrenjtë fitorja pas sakrificave të mëdha. Ndërsa sikur t'u vinte fitorja duke mos ua prekur gjërat që ata i duan, si p.sh. pasurinë, shtëpinë, pozitën, familjen etj., ato nuk do t'ia dinin vlerën kësaj fitoreje dhe për ta nuk do të ishte e rëndësishme, sepse akoma kanë gjëra të tjera sipas tyre të rëndësishme pas të cilave duhet të vrapojnë. Kështu që fitorja nuk do të ishte aq e rëndësishme për ta. Mirëpo fitoren nuk e sjell Allahu derisa për Umetin nuk bëhet çdo gjë e rëndësishme, derisa ata nuk do të sakrifikonin për të çdo gjë të kësaj bote e kështu pasi ta arrinin t'ia dinin vlerën ta ruanin dhe të kenë kujdes të mos u merret.

3. Vonohet që Umeti Islam t'i provojë të gjitha potencialet e tij dhe të bindet se asgjë nuk mund të jetë shkak për fitore, nëse ajo nuk bëhet përmes mbështetjes tek Allahu, përmes pasimit të rrugës së Tij. Muslimanët duhet ta përmirësojnë besimin e tyre dhe ta kuptojnë njëherë e mirë, se asgjë nuk mund të jetë shkak për

fitore pos Allahut Fuqplotë, i Cili është i vetmi që i ngre dhe i ul popujt. Ky Umet sikur të fitonte kundër armiqve me para, atëherë kjo gjë do të ishte me rrezik, sepse ata do ta donin parane ndoshta aq shumë sa edhe t'ua prishte besimin. Por fitorja arrihet vetëm përmes besimit, që besimi pastaj të jetë i shenjtë për ta.

4. Duke i përjetuar vështirësitë Umeti ynë lidhet edhe më shumë me Allahun dhe pasi Zoti të japë urdhër për fitore muslimanët nuk mund të bëhen të padrejtë si të tjerët që ishin me ta, pasi ata vetë e kanë provuar padrejtësinë dhe kështu e dinë se ç'do të thotë një ndjenjë e tillë. Kështu duke u bërë të drejtë njëherësh kanë arritur një nga kushtet më të rëndësishme të mbajtjes së pushtetit në duart e tyre, pra drejtësinë përmes së cilës Allahu i mban të rregulluar qiejt, token dhe çdo gjë që ekziston.

5. Ndodh të vonohet ndihma, për arsye se muslimanët ka raste kur luftojnë për synime jo të drejta, apo për qëllime të përfitimeve ose dëshirave të kësaj bote. Mundet që dikush të luftojë për pasuri, pushtet, famë, trimëri, krenari personale, e shkaqe të tjera, të cilat nuk mund të konsiderohen si luftë në rrugë të Allahut pas së cilës vjen ndihma e Zotit. Ndërsa Allahu kërkon nga ne që luftën secili ta bëjë vetëm për një qëllim dhe që është ngritja lart dhe mbi çdo gjë fjala dhe bindja se: ***“Allahu është i vetmi Zot që meriton adhurimin dhe Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij”***.

Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: ***“Kush lufton që ta ngrejë fjalën e Allahut mbi çdo fjalë tjetër ai është duke luftuar në rrugë të Zotit.”*** (Buhariu dhe

“...Që kjo padrejtësi e tyre t'i bëhet e qartë çdokujt në botë muslimanit apo qafirrit; dhe pasi të shkatërrohen këta të fundit askujt të mos i mbetet merak shkatërrimi i tyre...”

Muslimi)

6. Për shkak se të keqen që janë duke e luftuar muslimanët ndoshta akoma nuk iu është bërë e qartë mbarë botës dhe mund të ketë edhe prej vetë muslimanëve, që nuk e kanë kuptuar këtë të keqe të qafirëve sa duhet e kështu Allahu e vonon ndihmën dhe nuk i shkatërron ata, që kjo padrejtësi e tyre t'i bëhet e qartë çdokujt në botë muslimanit apo qafirrit; dhe pasi të shkatërrohen këta të fundit askujt të mos i mbetet merak shkatërrimi i tyre, apo askush të mos ëndërrojë që të njëjtat shtete të kufrit të kthehen prapë në pushtet, thënë me një fjalë askush të mos i kujtojë për të mirë dhe të mos dëshirojë rikthimin e tyre.

7. Ka raste kur ndihma vonohet, sepse shoqëria muslimane akoma nuk është e përgatitur ta pranojë të vërtetën ashtu si duhet, ta praktikojë atë dhe t'i qëndrojë besnik urdhrave të tij. Kështu nëse ndihma do të vinte para kohe do të ishte mundësia që vetë muslimanët t'i refuzonin detyrimet dhe kërkesat fetare. Kështu do të bëhej e lehtë arritja deri tek fitorja, por e vështirë mbajtja në duar e kësaj fitoreje.

8. Mosangazhimi ynë sa duhet është shkak që Allahu ta vonojë ndihmën, sepse

Zoti nuk ia jep askujt diçka pa punuar për ta arritur atë, gjithashtu dihet se çdo gjë që fitohet pa djersë dhe pa mund nuk vlerësohet sa duhet. Këto janë disa prej shkaqeve dhe urtësive të vonesës së ndihmës nga Allahu, të cilat kur të shkojnë në vendin e tyre atëherë prite ndihmën dhe mos dysho aspak për të.

Kur do të vijë ndihma e Allahut?

Ndihma vjen kur ne t'i kemi parasysh dhe t'i marrim seriozisht këto gjëra:

1. Gjendja në të cilën është Umeti ynë assesi nuk duhet të jetë shkak që ne t'i humbasim shpresat për rikthimin e asaj që na takon në fytyrën e tokës, përkundrazi ne duhet të kryejmë një punë shumë të madhe dhe me përfitim, duke dhënë maksimumin secili nga ne në fushën e vet.

2. Çdokush nga muslimanët duhet ta mbushë një vend të zbrazët në Umet dhe të përballët me armiqtë e Islamit në një front të caktuar, atëherë kjo gjë do të sillte sukses.

3. Një fjalë e urtë thotë: “Ajo nuk kthehet derisa nuk kthehemi”, pra nuk kthehet ndihma tek ne derisa ne nuk kthehemi kah ajo, apo e thënë më ndryshe derisa të mos i fillojmë t'i kryejmë detyrimet e Allahut, Ai nuk na e jep ndihmën. Të largohemi prej mëkateve. Allahu i çon telashet për shkak të mëkateve. Ai thotë: **“Kur ju goditi fatkeqësia, ndërkohë ju i kishit goditur më parë armiqtë tuaj dyfish, ju thatë: “Prej nga na erdhi neve kjo?!” Thuaj (o Muhamed): “Kjo ndodhi prej jush”. Vërtet, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”** Sahabët në luftën e Uhudit thyen një

urdhër të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e për shkak të saj pësuan humbje, ndërsa ne: a thua po i llogarisim sa herë secili nga ne i thyen urdhrat e Allahut dhe ato të Dërguarit të Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*?!

4. Të punosh për Islam, për arritjen e fitores, por kjo punë të karakterizohet prej rregullit, të jetë e qartë dhe në pajtim me kërkesat kuranore dhe ato profetike e jo të mbështetet në parregullsi, epshe dhe dëshira personale të secilit prej nesh, ngase një gjë e tillë nuk sjell asgjë tjetër pos dështimit, por edhe sikur të ndodhte të sillte shkëndija të fitores ato do të shuheshin shumë shpejt, sepse çdo gjë që ngrihet mbi çrregullime fundin e ka të shpejtë. Asnjëri prej nesh nuk duhet të punojë me epshe apo emocione, sepse armiqtë e Allahut një prej shkaqeve përmes të cilave kanë arritur t'i nënshtrojnë muslimanët është pasimi i rregullave të caktuara larg çdo emocioni dhe dëshire personale.

Durimi dhe devotshmëria janë dy kushte primare të fitores. Sabri është shkak për t'i duruar të gjitha vështirësitë në rrugë të Allahut. Ndërsa devotshmëria ta mundëson të vazhdosësh me programin jetësor që ke zgjedhur për të jetuar me të dhe gjithmonë është rifreskim i besimtarit për ta mbajtur larg çdo dëshpërimi deri në vdekje. Allahu thotë: **“Zoti është me durimtarët.”** (Bekare,153), gjithashtu i Lartësuari thotë: **“Fundi i mirë i takon të devotshmëve.”** (Araf, 128). ■

ASPEKTI SHKENCOR I NJË HADITHI MADHËSHTOR

Sipërfaqja e mizës është vendi i fundit ku do të pritej gjetja e antibiotikëve, por mu aty një ekip hulumtuesish australianë u fokusua. Ata e bazuan punën e tyre në teorinë se mizat mund të kenë diçka të rëndësishme - antibiotikë që do të mund të mbijetojnë në bajgën e kalbur, mish dhe fruta

PRIM. DR. MED. SC. ALI F. ILJAZI

Shpesh kritikët e Islamit e përqeshin Islamin veçanërisht kur është fjala për një hadith të saktë, i cili gjendet në përmbledhjen e Buhariut, i cili thotë që nëse miza bie në pije, atëherë duhet ta zhysim atë në tërësi, sepse në të gjendet ilaçi, por tani me sa duket, sipas një studimi shkencor, miza ngadhënjeu mbi përqeshjen e tyre. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: ***“Nëse miza bie në pijen tuaj, zhyten në pije, sepse në njërin krah të saj është sëmundja e në tjetrin ilaçi për këtë sëmundje.”***

ANTIBIOTIKËT E RINJ

Sipërfaqja e mizës është vendi i fundit ku do të pritej gjetja e antibiotikëve, por mu aty një ekip hulumtuesish australianë u fokusua. Ata e bazuan punën e tyre në teorinë se mizat mund të kenë diçka të rëndësishme - antibiotikë që do të mund të mbijetojnë në bajgën e kalbur, mish dhe fruta. Ekipi i “Departament of Biological Sciences, Macquarie University” filloi të identifikojë këtë cilësi antibakteriale, e cila paraqitet në stade të ndryshme të zhvillimit të mizës. *“Hulumtimi ynë është një pjesë e vogël e hulumtimit global në kërkim të antibiotikut të ri, por ne do të kërkojmë ku mendojmë se askush më parë nuk ka kërkuar.”* - ka thënë zonja Xhoan Klark, e cila ka prezantuar përparimin e grupit në Shoqatën e Australisë në Konferencën e Mikrobiologjisë në Melburn. Shkencëtarët kanë testuar katër lloje mizash: mizën shtëpiake, mizën ushtuese, mizën e vreshtave dhe mizën e

pemëve nga Kuislendi (Queensland), të cilat i vendosin vezët në ajër të pastër. Larvave të tyre nuk u nevojiten shumë materie antibakteriale, sepse ato nuk vijnë në kontakt me shumë bakterie. Miza kalon nëpër disa stade të ndryshme prej larvës e deri te miza e rritur. Gjatë stadi të zhvillimit miza mbyllet dhe nuk ushqehet. *“Kemi menduar se nuk do të prodhojnë shumë antibiotikë. Dhe nuk kanë prodhuar. Mirëpo të gjitha larvat tregojnë karakteristika antibakteriale (përveç në rastin e mizës së pemëve nga Kuislendi).”* - ka thënë zonja Klark.

Të gjitha llojet e mizave kur rriten kanë prodhuar antibiotikë, bile edhe miza e pemëve nga Kuislendi (së cilës në këtë stad i nevojitet mbrojtja antibakteriale, për arsye se ka kontakt me mizat e tjera). Këto cilësi ishin të pranishme në sipërfaqen e mizës te të katër llojet, edhe pse cilësia antibakteriale mund të jetë bile edhe në zorrë. *“Mund të gjenden aktivitetet në dy vende”* - thotë zonja Klark. *“Shkas që jemi koncentruar në sipërfaqe është se ky vend është më i lehtë për tajitje. Materia antibiotike tajitet pasi që miza zhytet në etanol, e pastaj përzierja lëshohet nëpër filtra për t’u tajitur koncentrat i thatë. Tani përpiqemi të zbulojmë vendin e veçantë antibakterial”* - thotë zonja Klark. Në fund bëhet sinteza kimike. Meqë këto vende nuk janë bakteriale gjenet që tregojnë rezistencë ndaj tyre, nuk do të kthehen lehtë në patogjene. Pritet që kjo formë e re e antibiotikëve të ketë veprim më të gjatë dhe efektiv. ■



ELIMINIMI I DRUAJTJES

I druajturi është një përfytyrues që parashikon gjithçka në dëm të tij. Ai është një person që përsërit prej vitesh se është i pazoti, i ngathtë, i paaftë, dështakë... etj., dhe çdo veprim që ai ndërmerr është i bindur në rezultatin e tij negativ. Ai pra është një viktimë e imagjinatës dhe e pasivitetit të vet

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Njeriu që ka druajtje nuk del kurrë fitimtar. Të druajturit nuk lindin të tillë, por bëhen. Për faj të ambientit, për faj të edukimit dhe për shkaqe të tjera. Në jetë mund të takosh çdo lloj individ,

por do të vëresh se ndërmjet të gjithëve i druajturi është më fatkeqi. Të druajturit nuk i bëhet e mundur të arrijë objektivin e synimeve dhe dëshirave të tij, edhe pse zotëron të gjitha dhuntitë nga Zoti. Është shumë më mirë të jesh një inteligjent i guximshëm, se sa një gjeni i druajtur. Dua të përgënjeshtroj këtu një legendë se

“...Është shumë më mirë të jesh një inteligjent i guximshëm, se sa një gjeni i druajtur...”

druajtja është trashëgimi e gjeniut, apo thënia se të gjithë gjenitë janë pak a shumë të druajtur, ndaj gjeniu i prekur nga druajtja duket më pak gjeni seç është në realitet.

Të druajturit janë të prirë të mbeten mbrapa dhe inferiorë. Personi i druajtur duhet të shërohet sidomos nga fantazia dhe ta konsiderojë atë një armike, sepse ajo është aleatja më e ngushtë e druajtjes përderisa ndihmon në zmadhimin e gjërave që krijojnë tronditje të thella. Nuk duhet të jesh i druajtur nga frika se mos kryen gabime. Gabimi më i madh i të gjithëve është të heqësh dorë nga eksperiencia. Rrënja e druajtjes duhet të kërkohet te mosbesimi në vetvete, sepse i druajturi është njeri tepër i ndjeshëm. Një nga format më të këqija të druajtjes është bindja e krijuar nga besimi i tepruar për rëndësinë e vetes, që bën të mendosh se të gjithë e kanë vëmendjen vazhdimisht tek ti, apo i mbajnë sytë të fiksuar mbi ty. Pra të druajturit e zmadhojnë rëndësinë e personalitetit të tyre përballë të tjerëve e kudo që kalojnë kanë përshtypjen, se të gjithë i vështrojnë, të gjithë merren me ta dhe të gjithë pëshpëritin diçka për ta. Kur i druajturi hyn diku për ndonjë arsye të vlefshme për të, ankthi i përshtypjes që do të krijohet i pengon çdo liri mendimi, fjalës të sjelljes dhe e bën të kryejë gafa duke e çuar në kulm konfuzionin e tij mendor.

Imagjinata është motori i madh i druajtjes. Ajo është prodhim i dëmshëm i kujtimeve të përpjekjeve të mëparshme të dështuara e të përshtypjeve katastrofike. Ajo asgjëson individin dhe individualitetin. I druajturi është një përfytyrues që parashikon gjithçka në dëm të tij. Ai është një person që përsërit prej vitesh se është i pazoti, i ngathtë, i paaftë, dështakë... etj., dhe çdo veprim që ai ndërmerr është i bindur në rezultatin e tij negativ. Ai pra është një viktimë e imagjinatës dhe e pasivitetit të vet, sepse në prani të qenieve guximtare e vullnetfortë nuk ndjen inkurajim, por thjesht një dorëheqje që e bën të thotë: “Unë nuk do të jem kurrë kështu”. Ajo që na bën të jemi optimist është fakti se nuk ekzistojnë të druajtur të pashërueshëm. Mjafton të futet në konflikt imagjinata me vullnetin dhe konflikti do të përfundojë në favor të vullnetit. I druajturi duhet të nisë t’i luftojë fillimisht këta armiq: Fantazitë, ndjenjën e rëndësisë, mosushqyerjen, pagjumësinë dhe nervozizmin. Defekti kryesor i të druajturit është të menduarit e tepërt, ndaj ata duhet të shmangin me çdo kusht të menduarit përtej masës dhe pa qenë nevoja, kështu që do të ishte e përshtatshme, që të druajturit të merren me punë dhe angazhime fizike sa më

“...Druajtja vret qysh në embrion dhuntitë më të mira të njeriut, ajo nuk është dukuri natyrore, por është një çrregullim psikik...”

shumë që të jetë e mundur. Druajtja vret qysh në embrion dhuntitë më të mira të njeriut, ajo nuk është dukuri natyrore, por është një çrregullim psikik, ajo është një nga dobësitë më të mëdha në jetë. Të druajturit kalojnë një ditë pas tjetrës të mbytur ne vetvete e të zhvendosur nga harmonia dhe lumturia.

Fëmijët shëndet dobët kanë një prirje më të theksuar për të qenë të druajtur. Një djalosh i druajtur është një individ që nuk di të paraqitet në një sallë, nuk di të hajë në prani të të huajve dhe kryen lloje të ndryshme gafash. Druajtja më shqetësuese është ajo që vjen nga mungesa e besimit në vetvete. Ajo zakonisht e ka rrënjën e saj nga një defekt fizik, që i është vënë shumë në dukje në fëmijëri. Pjesa më e madhe e të druajturve janë të tillë nga fëmijëria, sepse kanë qenë mësuar të mos zgjidhin kurrë asgjë vetë, por gjithmonë t'i drejtohen për ndihmë një vullneti tjetër superior. Kujdesi i tepruar krijon rezultate të këqija, ashtu siç krijon rreptësia e tepruar. Një shkak tjetër që e krijon druajtjen është fakti se shumë prindër kërkojnë përsosmërinë tek fëmijët e tyre. I druajturi duke pasur imagjinatë të tepruar, gjithçka tek ai ushtron një jetë të brendshme, është një spektator e asnjëherë aktor e pikërisht për këtë anon nga fantazia. Druajtja ia mpin të gjitha aftësitë e vullnetit, prandaj ai nuk mund të ketë veprime logjike, por sjellje të rrëmbyera. I druajturi është i prirë nga gënjeshtria jo se në vetvete ka dëshirë të gënjejë, por sepse në imagjinatën e tij ai i jeton faktet siç do të kishte dashur të ishin zhvilluar ato, e jo si

“...Njerëz të tillë preferojnë të udhëhiqen nga të tjerët dhe të kenë besim më tepër tek të huajt. Ata nuk janë të lumtur as në martesë...”

zhvillohen në realitet.

I druajturi është një vëzhgues i madh e arsyetues i hollë, por para së gjithash ai është një i sëmurë i keq, sepse për nga natyra e tij e ka zakon t'i shtyjë gjithmonë për nesër vendimet, duke nxjerr në pah arsye të pajustificuara, kështu që bëhet e vështirë të kuptohet thelbi se nga çfarë vuan ai. Njerëz të tillë preferojnë të udhëhiqen nga të tjerët dhe të kenë besim më tepër tek të huajt. Ata nuk janë të lumtur as në martesë! Ngase në të shumtën e rasteve lidhen me një grua që iu imponohet atyre e jo me atë që ata do të kishin zgjedhur lirisht. Atyre iu duken tepër të vështira fjalët që shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre. Është diçka e rrallë të gjendet një individ i druajtur, që të mos jetë keqdashës e i hidhur me të tjerët e të mos vuaj përballë sukseseve të tyre, ndaj edhe vuan, urren duke qenë mohues. Si rezultat i këtyre gjërave ai mbetet në jetë një person i izoluar dhe i pashoqërueshëm.¹ ■

Vazhdon....

■
¹ Marrë nga libri “Të mposhtës Druajtjen”.

SI TË THËRRAS NË RRUGËN E DREJTË

ZGJODHI DHE PËRKTHEU: AGIM BEKIRI

Pyetja 1. Nëse një njeri njihet me sjelljen e tij të keqe dhe mëkatet e mëdha i bën publikisht, si për shembull pirjen e alkoolit dhe të tjera, a lejohet që t'i këshillojmë të tjerët të largohen prej tij?

Përgjigje: Tërheqja e vërejtjes mëkatarit, atij që vepron mëkate të mëdha është detyrim, si dhe duhet të tregohet gjendja e tij, nëse ekziston frika që të tjerët të ndikohen prej tij. Gjithashtu është detyrim të këshillohen mëkatarët me shpresën se Allahu do t'i udhëzojë. I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Feja është të japësh këshilla të singerta! E pyetën: Për kë (këshilla)? Tha: Për Allahun, për Librin e Tij, për të Dërguarin, për prijësit e besimtarëve dhe për masën e gjerë.”* (Muslimi).

Komisioni i Përhershëm për Fetva
12/385-386

Pyetja 2. Do të udhëtoj në një vend në të cilin shumica e njerëzve janë injorantë

apo bidatçij, a mundet që t'i bëj disa përmirësime veprave dhe fjalëve të mia, në mënyrë që t'u iki disa fitneve dhe të përqendrohem në themele? Shembull për këtë: njerëzit të cilët nuk e kuptojnë Teuhidin, unë preferoj që t'u flas për Teuhidin në vend që të mbrohem pse i ngre duart gjatë tekbiereve në namaz dhe pse e lëviz gishtin apo gjëra të tjera të Sunetit?

Përgjigje: Së pari: nëse je që praktikon Sunete që kanë ardhur nga i Dërguari i Allahut nuk është e drejtë që të thuash “dëshiroj të bëj disa përmirësime”, ngase vetë ato vepra janë të përmirësuar, mirëpo ndoshta qëllimi i pyetjes tënde ishte që të mos i shfaqësh ato vepra para disa njerëzve duke shpresuar arritjen e disa dobive të caktuara dhe ikjen nga disa dëme po ashtu të caktuara. **Së dyti:** S'kam mëdyshje se angazhimi për të sqaruar Teuhidin dhe çështjet e akides në mesele, të cilat i përmende është prej veprave më të rëndësishme. Teuhidi është çelësi i thirrjes së të dërguarve, alejhim selam, dhe detyrimi i parë i njerëzve, si dhe është kushti themelor për pranimin e veprave.

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com



Nëse ndodh ose ke ndonjë supozim të fuqishëm, se veprimi i disa veprave të mira, siç është lëvizja e gishtit në namaz për shembull, mund të çojë në ndonjë fitne apo të komprometojë personalitetin tënd dhe njerëzit kjo gjë t'i largojë prej teje apo t'i preokupojë nga ajo që është më e rëndësishme, atëherë nuk prish punë që t'i braktisësh ato vepra duke pasur parasysh rrethanat. Allahu e di qëllimin tënd dhe se ti nuk i braktis ato nga pakujdesia, porse për një dobi të fesë dhe në këtë rast me lejen e Allahut shpërblehesh.

Muhamed Salih Munexhid

Pyetja 3. Cila është metoda më e preferuar për të thirrur në rrugë të drejtë lënësin e namazit dhe bidatçiun?

Përgjigje: Së pari: duhet që të shikojmë mirë gjendjen e atij që e thërrasim për të kryer namazin apo ndonjë ibadet tjetër duke pasur parasysh metodat e inkurajimit apo frikësimit në varësi se cila është më e përshtatshme, edhe pse në esencë përdoren të dy metodat. Pastaj me rëndësi të veçantë është psikologjia e atij që thirret, sa ndikohet nga këshilla dhe çka e afron apo e largon atë. **Së dyti:** mënyra më shembullore për thirrjen e

lënësit të namazit është si vijon:

përkujtimi se namazi është detyrim dhe se është shtylla më madhështore e fesë pas shehadetit.

Njoftimi i tij me disa vlera të namazit, se është detyrimi më i mirë me të cilin na ka ngarkuar Allahu, adhurimi më i mirë me të cilin i afrohemi Allahut, gjëja e parë për të cilën do të jepet llogari. Pesë namazet i shlyejnë mëkatet që bëhen mes tyre nëse i largohesh mëkateve të mëdha... dhe gjëra të tjera që kanë të bëjnë me vlerën e namazit. Më këto ndoshta i zbutet shpirti me lejen e Allahut, dhe namazi të bëhet kënaqësia shpirtërore, ashtu siç ishte për të Dërguarin e Allahut.

Njoftimi i tij për argumentet e shumta që kanë ardhur kundër atij që nuk e fal namazin, diskutimin e dijetarëve për statusin e tij: a është mosbesimtar apo mëkatar i madh, se Islami lënësin e namazit nuk e lejon të jetojë i lirë në mesin e njerëzve, ngase është detyrë që të thirret për t'u falur, nëse ngul këmbë në mosfalje vritet si murted (renegat) sipas mendimit të Ahmedit dhe dijetarëve të tjerë të selefit, apo dënohet me vdekje sipas mendimit të Shafiut, apo burgoset sipas mendimit të Ebu Hanifes, mirëpo të lihet i lirë asnjëri prej dijetarëve nuk e ka thënë. Prandaj lënësit të namazit i thuhet: a dëshiron që dijetarët ta polemizojnë statusin tënd, je mosbesimtar, duhet të vritesh apo të burgosesh?!

Përkujtimi se një ditë do të takohet me Allahun, se do të vdesë dhe do të varroset, dhe përfundimi i keq që mund ta zërë lënësin e namazit, si dhe dënimi i varrit.

Sqarimi se vetëm vonimi i namazit nga koha e tij është një mëkat shumë i madh.

Allahu thotë ***“pas tyre erdhën disa brezni të cilët e humbën namazin, pasuan epshet dhe do të marrin një dënim të madh.”*** (Merjem: 59).

Sqarimi se çka nënkupton thënia e dijetarëve se lënia e namazit është kufër i madh dhe çka rezulton ky mendim prej gjërave të mëdha: prishjen e nikahit të tij, ndalimi i qëndrimit me bashkëshorten, nuk i lahet kufoma kur vdes dhe nuk qefinohet. Ky mendim mbështetet në shumë hadithe të të Dërguarit sikur: ***“...mes njeriut dhe shirkut apo kufrit është lënia e namazit.”*** (Muslimi), si dhe ***“marrëveshja mes nesh dhe atyre (mosbesimtarëve) është namazi, kush e braktis atë ka bërë kufër.”***

Duhet t'i dhurojmë libërtha, kaseta që flasin për këtë temë.

Bojkotimi nëse ai ngul këmbë në mosfaljen e namazit.

Sa i takon bidatçiut, raporti me të është më ndryshe varësisht prej llojit të bidatit që ai bën. Është detyrim që të këshillohet dhe të thirret në rrugë të drejtë, t'i argumentohet e vërteta, t'i mënjanojnë dyshimet. Nëse ngul këmbë në bidatin e tij, atëherë bojkotohet nëse ekziston një supozim i fortë se një vendim i tillë do t'i bëjë dobi. Para kësaj duhet të kemi shumë kujdes për vlerësimin se një njeri është bidatçi apo jo duke iu referuar dijetarëve, duke bërë dallimin mes bidatit dhe vepruesit të saj, se ndoshta mund të jetë i arsyetuar me injorancë apo interpretim të gabuar. Allahu e di më së miri. ■

Muhamed ibën Salih Munexhid.